Udhëzime për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Parlament

Redaktorët
Fotios Fitsilis
Jörn von Lucke
Franklin De Vrieze

Korrik 2024

WFD

E drejta e autorit dhe politikat e përgjegjësisë

Attribution-JoCommercial-Share Alike CC BY-NC-SA

Të gjitha të drejtat në këtë punim, duke përfshirë të drejtat e autorit, janë në pronësi të Westminster Foundation for Democracy Limited (WFD) dhe mbrohen nga legjislacioni i zbatueshëm i Mbretërisë së Bashkuar dhe legjislacioni ndërkombëtar. Ky punim është licensuar sipas një license Attribution Non-Commercial ShareAlike Creative Commons. Kjo licensë ju lejon të riprodhoni, përshtatni dhe mbështeteni mbi këtë punim, por jo për qëllime tregtare, me kusht që të kreditoni WFD-në dhe të licensoni krijimet tuaja të reja sipas kushteve identike. Çdo leje jashtë objektit të kësaj license duhet t'i kërkohet WFD-së.

Informacioni dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë botim janë të autorit(ve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht opinionin zyrtar të WFD-së, financuesve të saj ose Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. As WFD-ja dhe as ndonjë person që vepron në emër të saj nuk mund të mbahet përgjegjës për përdorimin e informacionit që përfshihet këtu.

Versioni aktual i udhëzimeve u finalizua më 29 prill 2024.
Autorët kanë treguar të gjithë kujdesin dhe aftësinë e duhur për të siguruar që materiali të jetë i saktë në datën e këtij raporti. Megjithatë, përdorimet e mundshme të Inteligjencës Artificiale (AI) në parlamente janë të shumëllojshme dhe nuk mund të parashikohen plotësisht në planin afatgjatë, as nëse ato do t'i shërbejnë demokracisë dhe qeverisjes efektive apo do ta minojnë atë. Në këtë kontekst, autorët nuk mbajnë përgjegjësi për çdo humbje që mund të lindë nga kushdo që mbështetet në përmbajtjen e këtij botimi; dhe ata nuk marrin përsipër asnjë përgjegjësi në lidhje me efektet dhe implikimet e prezantimit dhe përdorimit të mjeteve dhe shërbimeve të bazuara në IA në parlament.

ISBN (versioni elektronik, AL) 978-1-0685174-6-4

Mirënjohje

Redaktorët dëshirojnë të shprehin mirënjohjen e tyre për komunitetin parlamentar global, diskutimet e gjalla dhe reagimet e paçmueshme të cilat ishin të dobishme në evoluimin e versionit 1.0 të Udhëzimeve për prezantimin dhe përdorimin e inteligjencës artificiale në hapësirën e punës parlamentare. Vështrimet kolektive të komunitetit e kanë pasuruar ndjeshëm këtë botim, duke e bërë atë një burim gjithëpërfshirës për institucionet parlamentare në mbarë botën.

Gjithashtu, falënderojmë Monica Palmiranin dhe ekipin e saj të përkushtuar në Universitetin e Bolonjës për ekspertizën dhe angazhimin e tyre gjatë gjithë procesit të zhvillimit. Kuptimi i tyre i thellë i aspekteve ligjore dhe teknologjike ka qenë thelbësor në formësimin e përmbajtjes së udhëzimeve.

Ne shprehim vlerësimin tonë të sinqertë për Fondacionin Westminster për Demokraci për qasjen e tyre vizionare në përqafimin e kësaj nisme dhe ofrimin e mbështetjes thelbësore për shpërndarjen e saj. Largpamësia dhe përkushtimi i tyre për forcimin e praktikave demokratike do të lehtësojnë shtrirjen globale të këtyre udhëzimeve, duke fuqizuar parlamentet në të gjithë kontinentet për të naviguar kompleksitetin e integrimit të IA-së në mënyrë efektive.

Kapitujt

1. Hyrje — Faqe 10

Pjesa tjetër e hyrjes përshkruan IA-në dhe IA-në gjeneruese, dhe përshkruan se përse kemi nevojë për udhëzime, sfidat e përdorimit të IA-së në një mjedis parlamentar dhe se si mund të përdoret IA-ja në parlamente.

2. Udhëzimet — Faqe 22

Pjesa 2 e dokumentit përmban udhëzimet. Pas një përmbledhjeje të udhëzimeve, udhëzimet e detajuara janë organizuar në gjashtë seksione, duke mbuluar një sërë çështjesh kritike:

- parimet etike
- inteligjenca e përgjithshme artificiale (AGI)
- privatësia
- qeverisja
- zhvillimi i sistemit
- ngritja e kapaciteteve

Secili prej 40 udhëzimeve është paraqitur në një format të strukturuar, duke synuar të trajtojë tri pyetjet kryesore:

- Pse ka rëndësi ky udhëzim?
- A ka shembuj të njohur të zbatimit të tij?
- Si mund të zbatohet ky udhëzim?

Në secilin udhëzim janë përfshirë konsiderata dhe rekomandime të shkurtra të mëtejshme.

3. Hapat e mëtejshëm — Faqe 80

Pjesa 3 përshkruan shkurtimisht hapat e mëtejshëm në zhvillimin e udhëzimeve për IA-në në parlament.

4. Lexim i dobishëm — Faqe 82

Pjesa 4 përmban listën e shkurtesave, fjalorthin dhe bibliografinë.

Autorët

Ky botim është hartuar nga një grup ndërkombëtar studiuesish dhe profesionistësh parlamentarë.

- **Dr. Fotios Fitsilis,** Parlamenti Helen
- **Prof. Dr. Jörn von Lucke,** Universiteti Zeppelin
- **Franklin De Vrieze,** Fondacioni Westminster për Demokraci
- **Prof. George Mikros,** Universiteti Hamad Bin Khalifa
- **Prof. Monica Palmirani,** Universiteti i Bolonjës
- **Alex Read, Chief Technical Specialist,** Kryespecialist Teknik, UNDP
- **Dr. Günther Schefbeck,** Parlamenti i Austrisë
- **Dr. Alicia Pastor y Camarasa,** Universiteti i Lozanës
- **Prof. Stéphane Gagnon,** Université du Québec en Outaouais
- **João Alberto de Oliveira Lima,** Senati Federal i Brazilit
- **Dr. Antonino Nielfi,** Parlamenti i Australisë
- **Georgios Theodorakopoulos,** Këshilli Ligjor i Shtetit Helen
- **Marina Cueto Aparicio,** Senado de España
- **Prof. Juan de Dios Cincunegui,** Universidad Austral
- **Ari Hershowitz,** Govable.ai
- **Ahto Saks,** Parlamenti i Estonisë
- **Jonas Cekuolis,** ekspert i zhvillimit parlamentar
- **Jonathan Ruckert,** NovaWorks Australi
- **Elhanan Schwartz,** Ministria e Drejtësisë e Izraelit
- **Prof. Zsolt Szabó,** Universiteti i Kishës së Reformuar Károli Gáspár, Universiteti Szechenyi Istvan
- **Prof. Nicola Lupo,** Universiteti LUISS
- **Marci Harris,** Fondacioni POPVOX

Parathënie

Tashmë jemi dëshmitarë të ndikimit të inteligjencës artificiale (IA) brenda hapësirës së punës parlamentare. Në një të ardhme jo shumë të largët, ne mund të shohim sisteme të IA-së dhe shërbime të bazuara në IA që mbështesin pa probleme anëtarët e parlamentit, si në procedurat parlamentare ashtu edhe në detyrat e tyre zgjedhore. Imagjinoni sisteme të besueshme vendimmarrëse, të mbështetura nga shërbimet e IA-së, duke lehtësuar gjykimet e informuara. Përfytyroni shqyrtimin inteligjent të propozimeve legjislative për harmonizimin e tyre me rregulloret ekzistuese, krahas monitorimit të diskursit politik të drejtuar nga IA-ja në platformat e mediave sociale.

Kjo nuk është fantashkencë. Edhe me aftësitë e sotme teknologjike, zgjidhje të tilla digjitale mund të zhvillohen dhe integrohen në sistemet parlamentare të TI-së, duke ndikuar ndjeshëm në funksionet institucionale dhe përfaqësuese.

Ky botim është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të një grupi pune të përbërë nga mbi 20 studiues dhe profesionistë parlamentarë. Udhëzimet që ai përmban përfshijnë parimet etike, inteligjencën e përgjithshme artificiale dhe autonominë njerëzore, privatësinë dhe sigurinë, qeverisjen dhe mbikëqyrjen, zhvillimin dhe funksionimin e sistemit, si dhe ngritjen e kapaciteteve dhe edukimin.

Botimi i këtyre udhëzimeve çon përpara të kuptuarit e IA-së nga ana jonë, por gjithashtu hedh bazat për integrimin e përgjegjshëm dhe gjithëpërfshirës të IA-së në praktikat parlamentare.

Fondacioni Westminster për Demokraci krenohet me përkrahjen e demokratizimit të IA-së dhe integrimin e saj në institucionet parlamentare. Teknologjitë e reja duhet t'i shërbejnë demokracisë, jo ta shtrembërojnë atë. Botimi i udhëzimeve të para për inteligjencën artificiale në parlament rikonfirmon angazhimin tonë për të udhëhequr inovacionin parlamentar. Ekipi ynë mbarëbotëror i ekspertëve të dedikuar do të vazhdojë të bashkëpunojë me studiues dhe parlamente të interesuara në zhvillimin dhe qeverisjen e teknologjive për të nxitur demokracinë në mbarë botën.

Anthony Smith

Drejtor Ekzekutiv,
Fondacioni Westminster për Demokraci

Korrik 2024

Parathënia e redaktorëve

Me kalimin e kohës, gjithnjë e më shumë parlamente kanë përqafuar mjetet dhe shërbimet digjitale. Rritja e inteligjencës artificiale pritet ta përshpejtojë më tej këtë prirje dhe të luajë rol të rëndësishëm në transformimin e legjislaturave nga organizata të drejtuara nga letra në institucione të drejtuara nga të dhënat.

Këto udhëzime synojnë t'i përgatisin institucionet përfaqësuese për prezantimin dhe përdorimin e IA-së në hapësirën e punës parlamentare. Ky botim u hartua nga një grup ndërkombëtar studiuesish dhe profesionistësh parlamentarë gjatë një periudhe 8-mujore, nga shtatori 2023 deri në prill 2024, duke u mbështetur në punën e mëparshme në këtë fushë.

Ne e pranojmë se udhëzimet mbeten një punim në progres brenda një konteksti teknologjik dhe institucional gjithnjë në ndryshim. Thënë këtë, udhëzimet kanë potencialin të sigurojnë rregullim të informuar për të fuqizuar parlamentet në formulimin e politikave, angazhimin publik, ngritjen e kapaciteteve dhe më shumë. Ato mund të ndihmojnë në sigurimin e integrimit të përgjegjshëm të IA-së, duke trajtuar transparencën dhe etikën në proceset politike dhe administrative, duke forcuar kështu besimin e publikut dhe duke mbrojtur interesin publik. Për më tepër, këto udhëzime mund të ndihmojnë në harmonizimin e mjeteve dhe shërbimeve të IA-së me parimet demokratike dhe nevojat shoqërore. Gjithashtu, ato kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndarjen e praktikave më të mira dhe sjelljen etike, duke mbështetur përfundimisht rritjen e njohurive dhe bashkëpunimin ndërmjet komunitetit parlamentar.

Këto udhëzime janë të rëndësishme për parlamentet vendore, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare në një kontekst qeverisjeje me shumë nivele. Ato ndjekin një qasje të gjithanshme, duke trajtuar etikën, privatësinë, sigurinë, mbikëqyrjen, zhvillimin e sistemit dhe edukimin. Ato shqyrtojnë aspekte specifike të përdorimit të IA-së në parlamente, duke përfshirë fushëveprimin, shembujt dhe faktorët që janë kritikë për zbatimin e suksesshëm. Kjo i bën ato të dobishme për trajtimin e çështjeve bashkëkohore dhe të rëndësishme për vlerësimin e atyre më teorike, siç janë pasojat e inteligjencës së përgjithshme artificiale (AGI) për legjislaturat.

Teknologjia ecën me shpejtësi. Prandaj, udhëzimet janë planifikuar për të qenë në përputhje me teknologjinë – me fjalë të tjera, ato nuk trajtojnë ndonjë teknologji specifike të IA-së. Megjithatë, janë përcaktuar tregues të prirjeve kryesore të teknologjisë, të tilla si IA-ja gjeneruese dhe hibride.

Shpresojmë që ky botim të shpërndahet sa më shumë që të jetë e mundur, për të arritur te çdo parlament, parlamentar, administrator dhe te kushdo tjetër që është vërtet i interesuar për të maksimizuar efektet pozitive të IA-së në legjislatura duke minimizuar rreziqet e mundshme. Kjo është pikërisht arsyeja se përse redaktorët dhe autorët e tjerë angazhohen të bashkëpunojnë më tej me palët e interesuara parlamentare dhe shoqërore për të nxitur zhvillimin e mëtejshëm të këtyre udhëzimeve. Komunikimi i udhëzimeve, bashkëpunimi dhe personalizimi do të ndihmojë në sigurimin e zbatimit dhe përshtatjes efektive në kontekste të ndryshme institucionale.

Ne mirëpresim propozime nga ata që janë të interesuar të punojnë me ne për të përkthyer udhëzimet, për të zhvilluar materiale trajnimi, për të ofruar mbështetje për zbatimin e tyre, ose për të ndarë praktikat më të mira për të përshpejtuar integrimin e tyre efektiv në hapësirën e punës parlamentare. Prova e konceptit dhe projektet pilot, qofshin ato njëpalëshe, dypalëshe ose shumëpalëshe, do të lejojnë testimin praktik dhe përsosjen e udhëzimeve në kontekste të ndryshme dhe ne presim të mësojmë prej tyre.

Fotios Fitsilis

Parlamenti Helen, Greqi

Jörn von Lucke

Universiteti Zeppelin, Gjermani

Franklin De Vrieze

Fondacioni Westminster për Demokraci, Mbretëria e Bashkuar

Korrik 2024

Përmbledhje ekzekutive

Konteksti

Inteligjenca artificiale (IA) ofron një mundësi transformuese për proceset parlamentare. Ajo mund të përdoret gjithnjë e më shumë për një sërë qëllimesh, si transkriptimi dhe përkthimi i debatit, përmbledhja e dokumenteve, mbështetja në hartimin e dokumenteve ligjore dhe komunikimi me qytetarët. Disa parlamente largpamëse po eksperimentojnë ose aplikojnë tashmë aplikacione të IA-së dhe përfitimet e mundshme janë thelbësore, duke përfshirë aspekte të ndryshme të funksioneve parlamentare.

Ndërsa ndikimi i IA-së në hartimin e legjislacionit është ende duke u studiuar, ai tashmë mund të kontribuojë në analizimin e vëllimeve të mëdha të dokumenteve ligjore, identifikimin e modeleve dhe sugjerimin e përmirësimeve. Për më tepër, algoritmet e IA-së mund të përmbledhin raporte të gjata, projektligje dhe gjetje të komisioneve, duke i bërë dokumentet parlamentare më të aksesueshme për ligjvënësit dhe qytetarët.

Në këtë mënyrë promovohet transparenca dhe lehtësohet vendimmarrja e informuar. Për më tepër, chatbot-et e fuqizuara nga IA-ja mund të angazhojnë qytetarët duke ofruar informacion në kohë reale për aktivitetet parlamentare, duke mundësuar kështu pjesëmarrje më të madhe të publikut. Modelet e IA-së mund të ofrojnë gjithashtu njohuri parashikuese duke parashikuar prirjet, ndikimet e mundshme të politikave dhe ndjeshmërinë e opinionit publik. Më pas, kjo largpamësi u mundëson ligjvënësve të trajtojnë në mënyrë proaktive çështjet e reja, duke rritur efektivitetin e punës parlamentare.

Që nga fundi i vitit 2022, ne kemi qenë dëshmitarë të miratimit të shpejtë të transformatorëve gjenerues të trajnuar paraprakisht (GPT), teknologjisë IA e cila ofron potencial të paparashikuar për të përmirësuar funksionet parlamentare. Ndërsa disa institucione u përgjigjën shpejt, shumica dërrmuese mbeten pa strategji të qartë, të pasigurt se si mund të zhvillohen, zbatohen dhe përdoren mjetet e IA-së. Këto udhëzime synojnë të stimulojnë inovacionin digjital dhe miratimin e përgjegjshëm, ndërsa parandalojnë kërcënimet që IA-ja mund të paraqesë për demokracinë dhe njerëzimin, sot dhe në të ardhmen.

Ky botim u zhvillua gjatë 8 muajve, nga shtatori 2023 deri në prill 2024, nga një grup pune teknik prej 22 studiuesish dhe profesionistësh parlamentarë ekspertë nga 17 vende. Dokumenti merr në konsideratë disa teknologji të IA-së dhe aplikimin e tyre të rëndësishëm për parlamentet; sfidat dhe barrierat për miratimin e tyre; dhe evolucioni i rregullores së IA-së.

Udhëzimet

40 udhëzimet e mëposhtme, të klasifikuara në gjashtë sektorë, ofrojnë udhëzime të përgjithshme për zhvillimin e kornizave rregullatore të përshtatura për parlamentet e së ardhmes.

Për secilin udhëzim, u është dhënë përgjigje një grupi pyetjesh kryesore: Pse ka rëndësi udhëzimi? A ka shembuj të njohur? Dhe, si mund të zbatohet? Çdo udhëzim përfundon me sugjerime se si t'i përdorim ato dhe se si palët e interesuara mund t'i miratojnë dhe përshtatin ato në projektet parlamentare të IA-së.

Numri i udhëzimeve për sektor

Figura 1 tregon shpërndarjen e udhëzimeve nëpër sektorë, duke përshkruar se ekspertët e vendosën qartë theksin te kuadri etik (10 udhëzime), duke i kushtuar rëndësi edhe AGI-së (3 udhëzime), sado e pamundur të jetë një perspektivë e tillë.

Udhëzimet theksojnë parimet etike, duke përfshirë llogaridhënien, transparencën dhe drejtësinë. Ata theksojnë rëndësinë e respektimit të dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe diversitetit kulturor, duke trajtuar gjithashtu paragjykimet në të dhëna dhe algoritme. Promovimi i autonomisë njerëzore dhe vendimmarrjes është nxjerrë në pah me njohjen e ndikimit të mundshëm të AGI-së. Konsideratat e privatësisë dhe sigurisë janë thelbësore, duke kërkuar masa të forta për të mbrojtur të dhënat personale dhe për të parandaluar sulmet kibernetike.

Udhëzimet përshkruajnë se si qeverisja dhe mbikëqyrja efektive janë thelbësore për të përafruar përdorimin e IA-së me vlerat demokratike dhe për të siguruar transparencë. Zhvillimi dhe funksionimi i sistemit duhet të kenë prioritet ndërveprueshmërinë, transparencën, besueshmërinë dhe sigurinë, krahas rregullimit dhe monitorimit të sistemeve të IA-së.

Për të pajisur parlamentarët dhe stafin me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për përdorim të përgjegjshëm të IA-së evidentohet ngritja e kapaciteteve dhe edukimi.

Inkurajohet bashkëpunimi me palët e interesit dhe përpjekjet për edukimin publik për të nxitur mirëkuptimin dhe pranimin e IA-së në proceset parlamentare. Bashkëpunimi ndërmjet parlamenteve dhe organizatave parlamentare konsiderohet thelbësor për shkëmbimin e përvojave dhe burimeve për të përshpejtuar zbatimin e IA-së.

Pjesa 1.

Hyrje

Në kontekstin e evoluimit të shpejtë dhe përdorimit të gjerë të mjeteve dhe shërbimeve të inteligjencës artificiale (IA) –përfshirë edhe në proceset parlamentare – është e nevojshme të përcaktohen udhëzime etike dhe operacionale që sigurojnë llogaridhënie, transparencë dhe autonomi njerëzore, duke promovuar qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e privatësisë, sigurisë dhe diversitetit.

Për këtë qëllim, në vitin 2013[1] u përgatit një grup i parë udhëzimesh (v1.0). Ky botim bazohet në grupin e parë të udhëzimeve për të zhvilluar një kuadër gjithëpërfshirës dhe të dobishëm për parlamentet në mbarë botën për t'u përdorur ndërsa lundrojnë në këto teknologji dhe aplikimin e tyre, dhe zhvillojnë kuadrin e tyre rregullator.

Ky botim nuk merr në konsideratë vetëm aplikimet e IA-së në hapësirën e punës parlamentare, por ka fokus më të gjerë, duke përshkruar mënyrat se si IA-ja mund të ndikojë në punën e parlamentarëve, administratës parlamentare dhe vetë institucionit të parlamentit.

Dokumenti përqendrohet në kufizimet dhe masat paraprake. Kjo nuk është për të shkurajuar parlamentet. Përkundrazi, parlamentet duhet të inkurajohen të kuptojnë më thellë dhe të përkrahin përdorimin e IA-së – por në kushte të caktuara dhe duke qëndruar vigjilentë ndaj rreziqeve dhe mundësive të përdorimit të IA-së në parlamente. IA-ja mund të ofrojë avantazhe të konsiderueshme në formimin e parlamenteve të së ardhmes. Kjo konsideratë duhet të jetë në plan të parë të diskutimit shumë të nevojshëm publik dhe politik rreth IA-së dhe demokracisë.

IA-ja është zhvillimi më i fundit në transformimin digjital të parlamenteve. Efektet e teknologjisë digjitale në legjislatura[2], si dhe në aspekte të ndryshme të një sistemi demokratik janë të mirëdokumentuara.[3] Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për IA-në, studiuesit zakonisht përdorin një qasje më konservatore sesa përçarëse kur studiojnë efektet e saj të mundshme në zhvillimin institucional. Megjithatë, ky kujdes tenton të anashkalojë faktin se IA-ja dhe IA-ja gjeneruese (nënzhanri më i spikatur i IA-së) janë faktorë të mundshëm ndryshimi në hapësirën e punës parlamentare, duke lehtësuar funksionimin më efikas, efektiv dhe transparent.

Përtej mbështetjes së thjeshtë, këto udhëzime ofrojnë një përmbledhje të potencialit pozitiv dhe sfidave shoqëruese të paraqitura nga këto teknologji në zhvillim.

Çfarë është IA-ja dhe IA-ja gjeneruese?

Fusha e IA-së është komplekse dhe gjithnjë në ndryshim dhe janë bërë shumë përpjekje për ta përshkruar atë.[4] Në vend të përkufizimeve ekzakte, ky botim përdor një sërë përshkrimesh më të përgjithshme për të përshtatur teknologjitë, konceptet, rreziqet dhe përfitimet që lidhen me futjen e IA-së në hapësirën e punës parlamentare.[5]

Termi inteligjencë artificiale i referohet një grupi teknologjish të ndryshme, metodash të të mësuarit, strukturave të sistemit, algoritmeve dhe qasjeve që përdorin kapacitetet kompjuterike për të përsëritur aftësitë e inteligjencës njerëzore në mënyrë që të kryejnë detyra të caktuara në mënyrë të pavarur ose me komandë. Ato përfshijnë: sistemet autonome, mësimin automatik, të nxënit e thelluar, rrjetet nervore, njohjen e modeleve, përpunimin e gjuhës natyrore, përkthimet në kohë reale, chatbot-et dhe robotët.

Aftësitë e ofruara nga IA-ja kanë për qëllim të mbështesin ose automatizojnë aktivitetet dhe proceset njerëzore. Njohja e modelit dhe tekstit, njohja e të folurit dhe folësit, njohja e imazheve dhe ajo hapësinore, si dhe njohja e fytyrës dhe e gjesteve paraqesin një gamë të gjerë aplikacionesh të mundshme. Sistemet e bazuara në IA për gjenerimin e tekstit, zërit, të folurit, imazhit, hapësirës dhe videove, si dhe programimi, zgjerojnë gamën e aplikacioneve. E gjithë kjo çon në sisteme, aplikacione dhe procese të reja për perceptimin, njoftimin, rekomandimin, prognozën, parandalimin, vendimmarrjen dhe ndërgjegjësimin e situatës bazuar në IA në kohë reale.

Inteligjenca artificiale gjeneruese, ndonjëherë etiketuar si GenAI, është në gjendje të gjenerojë përmbajtje të re në bazë të asaj që ka mësuar tashmë nga materiali i trajnimit. Ai nuk mbështetet vetëm në rastësi, por në modele të njohura dhe të mësuara për të gjeneruar të dhëna sintetike. Për shembull, modelet e mëdha gjuhësore (LLM) - të tilla si ChatGPT - mbështesin gjenerimin e tekstit dhe kodit, ndërsa shërbimet e përkthimit të bazuara në IA konvertojnë tekstet në gjuhë të ndryshme. Fushat e tjera të aplikimit përfshijnë gjenerimin e prezantimeve, programeve për sistemet e TI-së dhe planifikimin e rrjedhës së punës. Tekstet mund të përdoren edhe për të gjeneruar sekuenca zanore dhe tingujsh në tonalitete të ndryshme. Gjenerimi i imazheve dhe videove po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, me shumë persona të shqetësuar veçanërisht për rreziqet e krijimit të videove me sinkronizim të buzëve të bazuara në materialin e imazhit dhe regjistrimet audio (deepfakes).

Ka disa LLM në dispozicion, si me burim të hapur ashtu edhe me burim të mbyllur, dhe të vlerësosh se cili është më i përshtatshëm për një rast specifik përdorimi është një detyrë e rëndësishme nga këndvështrimi metodologjik. Disa prej tyre janë të mëdha, të tjerat janë të vogla dhe mund të instalohen në vend. Megjithatë, ka disa konsiderata rreth zbatueshmërisë së tyre në parlamente duke garantuar sovranitetin e infrastrukturës, duke parandaluar ndërhyrjen nga aktorët e jashtëm, duke mbrojtur pronësinë e të dhënave, duke siguruar gjurmueshmërinë dhe duke ruajtur legjitimitetin e të gjithë procesit.[6]

Pse na duhen udhëzime për përdorimin e IA-së në parlamente?

Udhëzimet ofrojnë strukturë, qëndrueshmëri dhe drejtim. Ato ndihmojnë në ndarjen e praktikave, rrisin mundësinë që zgjidhjet dhe qasjet të mund të riprodhohen në institucione të tjera dhe sigurojnë sjellje etike, duke nxitur rritjen e njohurive dhe duke lehtësuar bashkëpunimin midis studiuesve. Udhëzime të tilla ekzistojnë, për shembull, në fushën e sigurisë kibernetike[7] dhe mbrojtjes së të dhënave personale.[8]

Udhëzimet për IA-në në parlament mund të sigurojnë integrimin e përgjegjshëm të IA-së në punën parlamentare, duke trajtuar transparencën dhe shqetësimet etike në proceset institucionale administrative dhe vendimmarrëse, duke promovuar gjithashtu besimin e publikut. Për më tepër, ato mund të ndihmojnë për të siguruar përafrimin e mjeteve dhe shërbimeve të IA-së me parimet demokratike dhe nevojat shoqërore. Nga këndvështrimi ligjor, zhvillimi i udhëzimeve të tilla mund të kontribuojë në mënyrë thelbësore.[9]

Tabela e mëposhtme përshkruan disa nga parimet më domethënëse që duhet të rregullojnë integrimin e IA-së në kontekstin parlamentar krahas aplikimit të tyre të mundshëm në hapësirën e punës parlamentare. Në shkurt të vitit 2024, Dhoma Italiane e Deputetëve publikoi një grup të krahasueshëm parimesh[10]. Siç shihet qartë nga tabela, IA-ja ka potencialin për të shkaktuar ndryshime të shumta pozitive brenda ekosistemit parlamentar.

Këto parime janë përmbledhur në udhëzimet që përbëjnë pjesën 2 të këtij dokumenti. Këtu përfshihen edhe udhëzime në lidhje me sigurinë kibernetike dhe privatësinë e të dhënave.

Parimet përkatëse për IA-në në parlament	Aplikimi në hapësirën e punës parlamentare
Llogaridhënia dhe transparenca	Siguroni vendime dhe aplikime të kuptueshme, të gjurmueshme dhe të justifikueshme të IA-së
Autonomia e vendimmarrësit	Ruani autonominë e vendimmarrësit pa manipulim
Përdorimi etik dhe i përgjegjshëm i IA-së	Ruani standardet etike dhe parandaloni keqpërdorimet ose paragjykimet në aplikacionet e IA-së
Mbikëqyrja njerëzore dhe shpjegueshmëria	Ruani kontrollin njerëzor mbi sistemet e IA-së, por kini edhe aftësinë për të dhënë një shpjegim të orientuar drejt audiencave të ndryshme (p.sh. operatori ligjor, qytetari)
Zbutja e rrezikut dhe vlerësimi i ndikimit të të drejtave themelore (FRIA)	Identifikoni dhe trajtoni rreziqet e mundshme që lidhen me zbatimin e IA-së dhe që janë zbuluar nga FRIA
Besimi publik	Krijoni dhe ruani besimin e publikut në institucionet parlamentare që përdorin mjete dhe shërbime të IA-së
Përfshirja dhe diversiteti	Promovoni paanshmërinë dhe barazinë në proceset parlamentare administrative dhe vendimmarrëse
Përshtatja me përparimet teknologjike	Mundësojuni parlamenteve të përdorin përparimet e IA-së për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit operacional
Bashkëpunimi ndërparlamentar	Lehtësoni harmonizimin e politikave dhe rregulloreve globale të IA-së për parlamentet
Angazhimi publik	Përfshijini qytetarët dhe palët e interesit të shoqërisë në diskutime dhe vendime në lidhje me IA-në në parlament dhe integrimin e IA-së në hapësirën e punës parlamentare
Pajtueshmëria ligjore	Sigurohuni që zbatimet e IA-së në parlament të respektojnë ligjet dhe rregulloret përkatëse

Sistemet dhe zgjidhjet e IA-së për parlamentin

AI-ja ka potencialin të shkaktojë ndryshime të shumta pozitive brenda ekosistemit parlamentar dhe është e rëndësishme për shumë lloje shërbimesh parlamentare.

Në këtë dokument, autorët kanë zgjedhur një klasifikim tipologjik që ofron një gamë gjithëpërfshirëse aplikacionesh të bazuara në IA dhe nxjerr në pah mënyrat e ndryshme në të cilat IA-ja mund të përmirësojë proceset parlamentare, duke siguruar efikasitet, transparencë dhe përgjegjshmëri[11]. Tabela më poshtë paraqet shembuj të mënyrave se si IA-ja mund të përdoret në parlamente.

Aplikacionet kryesore parlamentare janë ndarë në grupe bazuar në rëndësinë e tyre. Ky kategorizim bazohet në sugjerimet e ekspertëve dhe në të dhënat empirike të mbledhura nga tre organe parlamentare: Parlamenti Helen, Dhoma e Nderuar e Deputetëve të Kombit Argjentinas dhe Parlamenti i Kanadasë.[12]

Aplikimet parlamentare të bazuara në IA

Grupi	Aplikimet e IA-së në parlament
Parlamentarët	▪ Titrim në kohë reale i fjalimeve të deputetëve në parlament ▪ Sisteme të besueshme votimi në seanca plenare dhe komisione ▪ Gjenerim i përmbajtjes për fjalime dhe pyetje me shkrim ▪ Mbështetje në marrjen e informacionit
Legjislacioni	▪ Shqyrtim i propozimeve legjislative për ndërveprim me rregulloret e tjera ▪ Rekomandime për legjislacionin bazuar në mangësit e identifikuara, problemet dhe ligjet tjera përkatëse ▪ Tekste paraprake për përpunim të mëtejshëm ▪ Rregullim më i mirë dhe zbatim politikash me gatishmëri digjitale
Kontrolli parlamentar dhe diplomacia parlamentare	▪ Analizë mediatike lidhur me aktivitetet e parlamentit ▪ Analizë e të dhënave të mediave sociale në lidhje me aktivitetet e parlamentit ▪ Zbulim i përpjekjeve për të shtrembëruar informacionin ▪ Masa për të reduktuar paragjykimet/diskriminimin brenda propozimeve të bazuara në IA për eliminim
Edukimi qytetar dhe kultura kombëtare	▪ Funksione inteligjente të kërkimit "front end" të faqes së internetit të parlamentit ▪ Transparencë përmes të dhënave të hapura (të lidhura). ▪ Vizualizim i argumenteve dhe diskutimeve ▪ Lehtësim i kontributit publik në procedurat parlamentare
Administrata parlamentare, ndërtesat e parlamentit, shërbimi i transportit dhe policia	▪ Asistentë virtualë për personat me aftësi të kufizuara ▪ Softuer për sigurinë kibernetike ▪ Shërbime të krijimit dhe përkthimit të procesverbaleve
Byroja parlamentare, drejtoritë parlamentar dhe zgjedhjet	▪ Zbulim i përmbajtjes së rreme të krijuar nga IA-ja që synon të manipulojë procesin demokratik ▪ Automatizim i procesit ▪ Menaxhim i projektit
Shërbime kërkimore/shkencore	▪ Kërkim inteligjent dokumentesh ▪ Menaxhimi i avancuar njohurish ▪ Verifikim faktesh

Kjo gamë e gjerë aplikacionesh të bazuara në IA nxjerr në pah mënyrat e ndryshme se si një teknologji e tillë mund të mbështesë, të thjeshtojë dhe madje të përmirësojë proceset parlamentare.

Sisteme të tilla, me nivele të ndryshme maturimi, po përdoren tashmë në parlamentet anembanë globit.[13] Shumica e këtyre sistemeve përdorin algoritme të përpunimit të gjuhës natyrore, ndërsa funksionalitetet më të përdorura janë transformimi i fjalës në tekst, klasifikimi i tekstit dhe njohja e modelit, e cila nga ana tjetër përfshin zërin, imazhet, objektet dhe njohjen e fytyrës.

Fokusi i sistemeve të tilla është i dyfishtë.[14] Së pari, parlamentet duket se u japin përparësi sistemeve të IA-së për të thjeshtuar proceset që lidhen me procedurat legjislative, duke përfshirë diskutimin, seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve. Së dyti, theksi vihet në shërbimet digjitale për qytetarët, duke përfshirë aksesin në informacion nga qytetarët dhe analizimin e reagimeve të marra nga qytetarët duke përdorur instrumentet e konsultimit publik.

Ekziston një prirje në zhvillim e parlamenteve që përdorin një sërë teknikash për zbutjen e rreziqeve të paraqitura nga vetëm një metodë, në vend të përdorimit të një qasjeje hibride.[15]

Sfidat dhe pengesat për përdorimin e IA-së në parlamente

Integrimi i IA-së paraqet mundësi të paprecedentë dhe sfida të mëdha kur bëhet fjalë për çështjet parlamentare.

Deri më tani ka mungesë të ligjeve dhe rregulloreve specifike për përdorimin e IA-së në parlament. Pasiguria që rezulton nga ky boshllëk rregullator mund të çojë në mungesë besimi te shërbimet e IA-së dhe ofruesit e tyre. Për më tepër, prania e cenueshmërive të mundshme të sigurisë kibernetike në zgjidhjet e IA-së shkakton shqetësime për sigurinë dhe integritetin e sistemeve parlamentare.

Për më tepër, njohuritë për IA-në janë ende të kufizuara, madje edhe në fushën inxhinierike, dhe aktorët parlamentarë nuk janë trajnuar sa duhet. Kjo mungesë njohurish jo vetëm që pengon integrimin dhe funksionimin efektiv, por gjithashtu i lë palët parlamentare të interesit të prekshme nga ndikimet e jashtme.

Ky dokument njeh IA-në si forcë transformuese dhe synon të "lundrojë në ujëra të panjohura" duke ofruar udhëzime për parlamentet për të shfrytëzuar përfitimet duke u mbrojtur nga rreziqet e mundshme.

Duke qenë se IA-ja hyn në fushën e parlamenteve, ekziston një nevojë urgjente për të përgatitur masa mbrojtëse dhe rregullore.[16] Duhet të trajtohen shumë konsiderata të rëndësishme për krijimin e një kuadri rregullator efektiv, duke përfshirë:

- Privatësinë e të dhënave dhe sigurinë e TI-së, si dhe aksesin në të dhëna dhe pronësinë e të dhënave.
- Opsionet e ndryshme të hostimit për sistemet e IA-së, të tilla si zgjedhja midis instalimeve në ambiente ose shërbimeve të bazuara në cloud, dhe rreziqet e tyre.[17]
- Portabilitetin e shërbimeve dhe të dhënave.
- Sigurimin e ofruesve të besueshëm të shërbimeve të IA-së me struktura të qarta pronësie, çështje dhe shqetësime etike për paragjykimet dhe cilësinë e të dhënave të trajnimit.
- Transparencën, shpjegueshmërinë dhe llogaridhënien – shtyllat kritike në krijimin e besimit të publikut në sistemet parlamentare të IA-së.
- Autonominë e vendimmarrësit, e cila është thelbësore për pranimin e sistemeve të IA-së si mjete mbështetëse për operatorët ligjorë.
- Aftësitë shumëgjuhëshe, të cilat janë parësore për zbatimin gjithëpërfshirës dhe efikas të IA-së.
- Pjesëmarrjen publike, e cila mund të përdoret për të vënë në praktikë vlerat demokratike dhe për të siguruar një perspektivë të jashtme në çdo kohë.

Për më tepër, nevojiten standarde dhe korniza për integrimin e teknologjisë së IA-së në punën e përditshëm parlamentar. Për shembull, nevojiten rregullore mbi fushën e ruajtjes dhe fshirjes së të dhënave, mbikëqyrjen etike dhe monitorimin e vazhdueshëm për të siguruar që sistemet e IA-së në parlamente të përmbushin standardet më të larta. Kjo çon përsëri në domosdoshmërinë e standardeve të cilësisë për sisteme të tilla.

Meqenëse shumë pak parlamente kanë gjasa të kenë ekspertizën dhe burimet për të trajtuar çështjet e mësipërme, ky dokument paraqet rastin për bashkëpunim ndërinstitucional dhe ndërparlamentar.

Në përgjithësi, këto udhëzime synojnë të vendosin një ekuilibër midis shfrytëzimit të potencialit transformues të IA-së dhe ruajtjes së integritetit të sistemeve parlamentare.

Evoluimi i rregullores së IA-së

Çështja e rregullimit të IA-së në parlament nuk është marrë ende seriozisht në shqyrtim nga parlamentet. Spektri i mundshëm i qasjeve ndaj IA-së në parlament varion nga integrimi i plotë deri te mohimi i saj. Pengesat dhe rregulloret mund të kufizojnë çdo forcë dhe mundësi që po krijohet. Kjo divergjencë nxjerr në pah një proces të vazhdueshëm evoluimi, që kërkon përgatitjen e udhëzimeve për të drejtuar parlamentet që ta përkrahin me përgjegjësi IA-në.

Ndryshe nga instrumentet jodetyruese ose "ligji i butë", si rezolutat, kodet e sjelljes ose udhëzimet, instrumentet ligjërisht detyruese ose "ligji i fortë", mund të përfshijnë rregullore, direktiva dhe ligje.

Ja vlen të përmenden dy instrumente të rëndësishme ligjërisht detyruese: Së pari, Parlamenti Evropian miratoi disa rezoluta përkatëse përpara se të miratonte përfundimisht Ligjin e IA-së në mars të vitit 2024.[18] Ligji i IA-së përcakton një sërë detyrimesh për zhvilluesit dhe zbatuesit që përkrahin një qasje të bazuar në rrezik, duke përfshirë kryerjen e një vlerësimi të ndikimit të të drejtave themelore (FRIA[19]) për aplikacionet me rrezik të lartë. Gjithashtu, ligji përcakton disa aplikime të sistemeve të IA-së në fushën parlamentare si me rrezik të lartë dhe përshkruan detyrime të veçanta në lidhje me këto aplikacione.

Së dyti, Këshilli i Evropës ka finalizuar Konventën Kuadër për IA-në, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës. Së shpejti, ajo do të jetë e hapur për miratim dhe ratifikim.[20] Konventa është instrumenti i parë ligjërisht detyrues për IA-në, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës. Megjithatë, ajo nuk përmban detyrime shtesë që do të zbatoheshin për parlamentet në lidhje me përdorimin e teknologjive të IA-së. Rruga drejt kësaj konvente u hap në vitin 2020, kur Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) miratoi rezoluta dhe rekomandime që shqyrtojnë pasojat e IA-së në të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës.[21]

Ndërkohë, në mars të vitit 2024, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ndërmori një hap të rëndësishëm duke miratuar një rezolutë që synon të orientojë përdorimin e IA-së drejt së mirës globale. Qëllimi i rezolutës është të nxisë sisteme të sigurta, të mbrojtura dhe të besueshme të IA-së, duke përshpejtuar kështu përparimin drejt realizimit të plotë të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.[22] Kjo rezolutë, si dhe Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nuk janë ligjërisht detyruese, edhe pse ato mund të përdoren nga dokumentet rregullatore rajonale dhe kombëtare si një "busull morale" për të arritur qëllimet kryesore.

Megjithëse që prej fillimit të vitit 2024 ka pasur përpjekje të konsiderueshme për të rregulluar IA-në, nuk ka udhëzime ose parime të përcaktuara që rregullojnë përdorimin e IA-së brenda parlamenteve, institucioneve supreme të demokracisë.[23] Një sondazh i kryer në fund të vitit 2022 – përpara prezantimit të shërbimeve bazë falas përmes ChatGPT të OpenAI – zbuloi ekzistencën e 39 zgjidhjeve aktive të IA-së në 10 organe parlamentare.[24] Futja e ChatGPT-së shkaktoi një rritje të interesit për zgjidhjet gjeneruese të IA-së me pasoja direkte ose indirekte për legjislacionin.[25] Në vitin 2023, Kongresi Amerikan autorizoi 40 licensa ChatGPT Plus për të eksploruar IA-në gjeneruese brenda radhëve të tij. Këto licensa u shpërndanë ndërmjet zyrave të kongresit, duke u mundësuar ligjvënësve dhe stafit të eksperimentojnë me këtë teknologji transformuese brenda organizatës.[26] Në prill të vitit 2024, Komiteti për Administrimin e Dhomës së Përfaqësuesve (CHA) i Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së lëshoi një sërë masash të përgjithshme mbrojtëse që do të përdoren për çdo mjet ose teknologji të IA-së që përdoret brenda Dhomës.[27]

Në vitin 2017, në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar u regjistrua një Grup Parlamentar me të Gjitha Partitë (APPG) për IA-në, çka përbën përpjekjen e parë parlamentare në botë për të diskutuar përdorimet dhe pasojat e teknologjisë. Në mars të vitit 2023, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar publikoi një dokument paraprak që përshkruan qasjen e saj të propozuar pro inovacionit për rregullimin e IA-së. Ky kuadër synon të jetë proporcional, i qëndrueshëm për të ardhmen dhe mbështetës i inovacionit.[28] Më pas, në nëntor të vitit 2023, Dhoma e Lordëve ishte nismëtar e një projektligji të anëtarëve privatë për rregullimin e IA-së. Aktualisht në fazën e komisionit, ky projektligj dhe projektligje të ngjashme janë aktualisht në diskutim në të gjithë globin, duke nxjerrë në pah nevojën për të përshtatur një teknologji kaq të fuqishme brenda kufijve të pranueshëm.

Në pritje të integrimit të mëtejshëm të mjeteve dhe shërbimeve të IA-së në hapësirën e punës parlamentare, po bëhen përpjekje për të hartuar udhëzime dhe rregullore. Në prill të vitit 2023, një grup i posaçëm pune përgatiti versionin origjinal të një grupi udhëzimesh që trajtojnë futjen dhe përdorimin e IA-së në hapësirën e punës parlamentare. Ky version aktual, v2.0, bazohet në themelet e hedhura nga pararendësi i tij.

Metodat për zhvillimin dhe përmirësimin e udhëzimeve

Metodologjia që grupi teknik i punës ndoqi për të zhvilluar këto udhëzime u bazua në njohuritë ekzistuese, analizën e literaturës dhe njohuritë e ekspertëve të çështjeve parlamentare. Puna filloi në shtator 2023 dhe përfundoi në prill 2024. Procesi i përsëritur i përditësimit të udhëzimeve u plotësua nga një seminar ndërveprues.

Me pjesëmarrjen e më shumë se 20 ekspertëve, procesi i hartimit të këtyre udhëzimeve hasi që në fillim në sfida të rëndësishme për arritjen e marrëveshjes unanime. Kompromiset ishin pjesë përbërëse gjatë gjithë procesit. Ky botim përbën rezultatin e kësaj përpjekjeje të ekuilibruar. Në fund të fundit, është përgjegjësi e parlamenteve individuale të përcaktojnë parametrat e tyre, të hartojnë strategji dhe të përcaktojnë prioritetet bazuar në këto udhëzime.

Sinteza e inteligjencës njerëzore dhe aftësive të avancuara të inteligjencës artificiale, duke përfshirë platformat bashkëpunuese të tekstit dhe modelet e mëdha gjuhësore (LLM), përbën themelin e këtij procesi kërkimor. Ekspertët morën pjesë në diskutime të ndryshme për të gjeneruar ide, duke përdorur si metodat klasike njerëzore, ashtu edhe mundësitë e reja që ofrojnë teknologjitë inovative të bazuar në modele të mëdha gjuhësore LLM. Analiza krahasuese me udhëzimet e krijuara nga IA-ja, nga modele si ChatGPT i OpenAI (GPT-3.5 dhe GPT-4), pasuroi të kuptuarit dhe vlerësimin e zgjidhjeve të propozuara.

40 propozimet që u zhvilluan ndahen në gjashtë sektorë, të cilët iu nënshtruan analizave të detajuara, duke përfshirë parimet e të menduarit të dizajnit për të përmirësuar aspektet me në qendër përdoruesin.

Pjesa 2.

Udhëzime

për Përdorimin e Inteligjencës Artificiale në Parlament

Përmbledhje e udhëzimeve

1. Parimet etike 24

1.1. Llogaridhënia dhe transparenca 26
1.2. Respektimi i dinjitetit, të drejtave dhe privatësisë së njerëzve 27
1.3. Drejtësia, barazia dhe mosdiskriminimi 28
1.4. Trajtimi i paragjykimeve në të dhëna dhe algoritme 29
1.5. Mbështetja e të drejtave të pronësisë intelektuale 30
1.6. Ruajtja e vlerave njerëzore dhe diversitetit kulturor 31
1.7. Vlerësimi dhe zbutja e pasojave të padëshiruara 32
1.8. Pjesëmarrja dhe angazhimi i publikut 33
1.9. Respektimi i shtetit të së drejtës dhe vlerave demokratike 34
1.10. Promovimi i qëllimeve të politikave 35

2. Inteligjenca e përgjithshme artificiale (AGI) dhe autonomia njerëzore 36

2.1. Promovimi i autonomisë njerëzore 38
2.2. Kërkesat etike për projektuesit dhe zhvilluesit 39
2.3. Të kuptuarit e AGI-së si perspektivë reale 40

3. Privatësia dhe siguria e IA-së 42

3.1. Integrimi i sigurisë dhe veçorive të qëndrueshme të sigurisë 44
3.2. Përfshirja e koncepteve të privatësisë sipas dizajnit 45
3.3. Përpunim i sigurt i informacionit personal të identifikueshëm 46
3.4. Konsideratat e kontraktimit 47
3.5. Shqyrtimi i çështjeve të sovranitetit të të dhënave 48
3.6. Sigurimi i integritetit të materialit burimor 49
3.7. Rreziku i mbështetjes së tepërt në IA 50
3.8. Sigurimi i të dhënave të trajnimit dhe testimit 51
3.9. Mbikëqyrje njerëzore në vendimet e sigurisë 52

4. Qeverisja dhe mbikëqyrja e IA-së 54

4.1. Integrimi në një strategji më të gjerë parlamentare digjitale 56
4.2. Protokollet efikase të qeverisjes dhe menaxhimit të të dhënave 57
4.3. Krijimi i një organi të mbikëqyrjes parlamentare etike 58
4.4. Vlerësimi i efekteve të IA-së parlamentare 59
4.5. Sigurimi i aksesit dhe kontrollit mbi të dhënat 60
4.6. Bashkëpunimi me palët e interesit 61

5. Projektimi dhe funksionimi i sistemit të IA-së 62

5.1. Zbatimi i skemave dhe proceseve të standardizuara të të dhënave 64
5.2. Evidentimi i shpjegueshmërisë së algoritmeve të IA-së 65
5.3. Ndërtimi i sistemeve të forta dhe të besueshme të IA-së 66
5.4. Rregullimi i përdorimit dhe zbatimit të sistemeve të IA-së 67
5.5. Vlerësimi i rrezikut 68
5.6. Monitorimi dhe vlerësimi i sistemeve të IA-së 69
5.7. Rënia dakord për nivelet minimale të saktësisë 70

6. Ngritja e kapaciteteve dhe edukimi për IA-në 72

6.1. Ngritja e ekipeve të ekspertëve 74
6.2. Organizimi i programeve të trajnimit 75
6.3. Mbështetja e shkëmbimit të njohurive dhe bashkëpunimit 76
6.4. Dokumentimi i aktiviteteve të lidhura me IA-në 77
6.5. Edukimi i publikut për përdorimin dhe kufizimet e IA-së në parlament 78

1. Parimet etike

Demokracia mbështetet në llogaridhënie dhe transparencë, që janë parimet kryesore të institucioneve parlamentare kudo. Parimet etike ofrojnë një kuadër për zhvillimin dhe zbatimin e sistemeve të IA-së parlamentare që janë të besueshme, transparente dhe në përputhje me vlerat njerëzore. Ky kuadër ndihmon për të siguruar maksimizimin e përfitimeve të IA-së duke minimizuar dëmet e mundshme.

Është e domosdoshme që kur zhvillohen, zbatohen dhe përdoren teknologjitë e IA-së, të mbizotërojë respekti për dinjitetin njerëzor dhe privatësinë – si dhe drejtësia, barazia dhe mosdiskriminimi, ndër vlerat dhe parimet e tjera. Parlamentet duhet të trajtojnë paragjykimet në të dhëna dhe algoritme dhe të ndihmojnë në ruajtjen e vlerave njerëzore dhe diversitetit kulturor, për shembull nëpërmjet trajnimit dhe zbatimit të kujdesshëm të modeleve. Për këtë do të kërkohen kritere të reja për vlerësimin dhe zbutjen e çdo pasoje të paqëllimshme nga IA-ja. Pjesëmarrja dhe angazhimi i publikut do të bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për të siguruar konsensus rreth IA-së dhe përshtatjes së saj në çdo kontekst parlamentar. Në fund të fundit, respektimi i shtetit të së drejtës dhe vlerave demokratike janë në rrezik.

1.1. Siguroni llogaridhënie dhe transparencë

> Pse ka rëndësi?

Sigurimi i llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin dhe zbatimin e sistemeve të IA-së parlamentare është i nevojshëm për të ruajtur integritetin e proceseve demokratike dhe për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e qytetarëve.

> A ka shembuj të njohur?

Në vitin 2020, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) miratoi rezoluta dhe rekomandime që shqyrtojnë pasojat e IA-së në demokraci, të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës.[29] Ajo miratoi edhe një sërë parimesh themelore etike që duhen respektuar gjatë zhvillimit dhe zbatimit të aplikacioneve të IA-së. Këto parime përfshijnë, ndër të tjera, transparencën dhe llogaridhënien njerëzore për vendimet algoritmike.

> Si mund të zbatohet?

Për të promovuar llogaridhënien, auditueshmërinë dhe transparencën në sistemet e IA-së parlamentare, parlamentet duhet të zbatojnë politika të qarta përdorimi, t'u japin përparësi parimeve etike dhe të krijojnë organe të pavarura auditimi për mbikëqyrje. Për më tepër, parlamentet duhet të krijojnë praktika transparente të të dhënave, si dhe llogaridhënie algoritmike, dhe të raportojnë rregullisht mbi performancën dhe algoritmet e sistemit. Në këtë drejtim, IA-ja e shpjegueshme është një qasje e rëndësishme që meriton të inkurajohet, por po përballet me kufizime teknike.[30] Angazhimi me palët e interesit dhe ekspertët për reagime dhe për të trajtuar paragjykimet nuk duhet të neglizhohet. Në fund të fundit, përfshirja aktive legjislative në mbikëqyrjen e vazhdueshme të sistemit duhet të jetë normë.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Inkurajojini institucionet kërkimore dhe akademike për të kryer vlerësime të pavarura të sistemeve të IA-së të përdorura në proceset parlamentare.
- Nxitni një kulturë llogaridhënieje dhe transparence brenda mjedisit parlamentar, ku anëtarët dhe stafi inkurajohen t'i respektojnë këto parime.

1.2. Respektoni dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut dhe të drejtat themelore, si dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave

> Pse ka rëndësi?

Organet parlamentare mund të sigurojnë që teknologjitë e IA-së të përdoren në mënyrë etike dhe me përgjegjësi. Respektimi i dinjitetit njerëzor dhe privatësisë në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe zbatimit të IA-së është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të individëve të përfshirë ose të prekur nga proceset parlamentare brenda hapësirës së punës institucionale.

> A ka shembuj të njohur?

Parimet e përshkruara nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) në vitin 2020 përfshijnë drejtësinë, ndershmërinë, privatësinë dhe të tjera, dhe duhet të respektohen gjatë zhvillimit dhe zbatimit të aplikacioneve të IA-së.[31]

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet mund të mbështesin dinjitetin njerëzor dhe privatësinë në IA duke miratuar rregulla dhe politika të rrepta për mbrojtjen e të dhënave, duke zbatuar udhëzimet etike të IA-së dhe duke kryer vlerësime të rregullta të ndikimit në privatësi. Për më tepër, sistemet transparente të IA-së mund të sigurojnë që informacioni personal të trajtohet me kujdes dhe që të drejtat dhe dinjiteti i individëve të respektohen.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Përcaktimi i një zyrtari për mbrojtjen e të dhënave (DPO) ose mbrojtësi të privatësisë brenda sistemit parlamentar kontribuon në mbikëqyrjen e respektimit të privatësisë dhe ofrimin e udhëzimeve. Në kontekstin e Bashkimit Evropian, DPO-të janë prezantuar përmes Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR).[32]
- Përveç kësaj, mund të konsiderohet një kod etik specifik për përdorimin e IA-së në parlament, i cili përfshin parime që lidhen me privatësinë dhe dinjitetin njerëzor.

1.3. Zbatoni parimet e drejtësisë, barazisë dhe mosdiskriminimit

> Pse ka rëndësi?

Zbatimi i parimeve të drejtësisë, barazisë dhe mosdiskriminimit në përdorimin dhe zbatimin e sistemeve të IA-së parlamentare është thelbësor për të siguruar që këto teknologji të mos përjetësojnë paragjykime ose pabarazi në kuadër të proceseve politike ose institucionale.

> A ka shembuj të njohur?

Në vitin 2020, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) mbështeti një koleksion parimesh themelore etike për zhvillimin dhe zbatimin e aplikacioneve të IA-së.[33] Këto parime përfshijnë, ndër të tjera, drejtësinë dhe ndershmërinë. Është miratuar një rezolutë që parandalon diskriminimin e shkaktuar nga përdorimi i inteligjencës artificiale.[34]

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet mund t'i promovojnë këto parime të IA-së duke siguruar ekipe të ndryshme të zhvillimit të IA-së, duke kryer auditime të paragjykimeve dhe duke përcaktuar udhëzime të qarta për të zbutur paragjykimet në proceset vendimmarrëse. Rishikimi i rregullt i sistemeve të IA-së për pabarazitë e mundshme dhe trajtimi i tyre i menjëhershëm i përforcon më tej këto parime.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

Paragjykimet janë pjesë e pandarë dhe, në fakt, komponentë thelbësorë të proceseve politike. IA-ja mund të ofrojë mjete të vlefshme për identifikimin e paragjykimeve të ndryshme, duke ndihmuar kështu argumentimin e strukturuar politik. Fokusi këtu është në paragjykimet diskriminuese të padëshirueshme, që mund të shkaktohen nga të dhënat e pamjaftueshme ose jo të balancuara të trajnimit. Trajtimi i çështjeve të tilla mund të kërkojë angazhimin me komunitetet e margjinalizuara dhe grupet e advokimit për të mbledhur reagime mbi ndikimet e sistemeve të IA-së dhe për të bërë përmirësime në përputhje me rrethanat. Për më tepër, mund të krijohet një kulturë e përdorimit etik të IA-së brenda parlamentit, ku drejtësia, barazia dhe mosdiskriminimi janë vlerat bazë. Për më tepër, parlamentet mund të bashkëpunojnë me institucionet kërkimore dhe organizatat e shoqërisë civile për të kryer studime mbi ndikimin e IA-së në drejtësi dhe barazi në proceset parlamentare.

1.4. Kuptoni dhe trajtoni paragjykimet e mundshme në të dhënat dhe algoritmet themelore

> Pse ka rëndësi?

Kuptimi dhe trajtimi i paragjykimeve të mundshme[35] në të dhënat hyrëse të trajnimit është një hap kritik për të siguruar që sistemet e IA-së të përdorura në proceset parlamentare të respektojnë parimet e drejtësisë, barazisë dhe mosdiskriminimit. Institucionet parlamentare mund të trajtojnë në mënyrë proaktive paragjykimet e mundshme në algoritmet dhe të dhënat hyrëse të trajnimit, duke siguruar që sistemet e IA-së të kenë më shumë gjasa të prodhojnë rezultate të drejta dhe të paanshme në mbështetje të proceseve të vendimmarrjes politike ose institucionale.

> A ka shembuj të njohur?

Ekziston një sërë rreziqesh paragjykimi në varësi të aplikimit të IA-së, i cili gjithashtu lidhet me trajnimin dhe zhvillimin e modeleve të themelimit. Urdhri Ekzekutiv i SHBA 14110 trajtoi, ndër të tjera, çështje të lidhura me paragjykimet.[36]

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet mund të zbatojnë parimet duke shqyrtuar dhe audituar tërësisht burimet e të dhënave të trajnimit për të zbuluar dhe zbutur paragjykimet. Përveç kësaj, ato mund të përdorin metoda transparente të mbledhjes së të dhënave, të sigurojnë grupe të dhënash të ndryshme dhe përfaqësuese, dhe të vlerësojnë rregullisht rezultatet e sistemit të IA-së për të identifikuar dhe korrigjuar paragjykimet e mundshme, si në të dhënat ashtu edhe në algoritmet e përdorura. Megjithatë, disa kundërveprime ndaj paragjykimeve të të dhënave mund të jenë të diskutueshme në aspektin etik, në rastin më të mirë, ose të kërkojnë metoda dhe teknologji që nuk janë zhvilluar ende.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Promovoni një kulturë të etikës[37] së të dhënave brenda hapësirës së punës parlamentare, duke theksuar rëndësinë e trajtimit të paragjykimeve.
- Nxitni bashkëpunimin me institucionet akademike dhe organizatat kërkimore për t'u përditësuar mbi praktikat më të mira në zbulimin dhe zbutjen e paragjykimeve.
- Merrni parasysh publikimin e raporteve të transparencës që detajojnë hapat e ndërmarrë për të trajtuar paragjykimet në sistemet e IA-së dhe ndikimin e tyre në drejtësi dhe barazi.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të pranohet se përdorimi i të dhënave historike është në thelb i njëanshëm në pothuajse të gjitha kontekstet. Trajtimi i këtij paragjykimi shpesh kërkon ndërhyrje jo vetëm në shtresën e të dhënave të trajnimit, por edhe brenda shtresës algoritmike. Megjithatë, nëse "ndërhyrje" nënkupton, për shembull, përjashtimin e të dhënave të caktuara për shkak të një qëndrimi politik, ne hyjmë në një territor të vështirë dhe të rrezikshëm.

1.5. Shmangni përdorimin e të dhënave të trajnimit që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale

> Pse ka rëndësi?

Shmangia e përdorimit të të dhënave të trajnimit që cenojnë të drejtat e pronësisë intelektuale (PI) nuk është vetëm një detyrim etik, por edhe një kërkesë ligjore. Kur përdoren të dhëna joparlamentare të palëve të treta, përdorimi i të cilave devijon nga qëllimi fillestar i publikimit, mund të lindin probleme. Kur zhvillohen sisteme të IA-së për përdorim parlamentar, duhet të respektojmë ligjet dhe rregulloret përkatëse të PI-së. Institucionet parlamentare mund të sigurojnë që proceset e tyre të zhvillimit të IA-së të respektojnë të drejtat e PI-së dhe t'u përmbahen standardeve etike dhe ligjore, duke zbutur rrezikun për shkelje të PI-së.

> A ka shembuj të njohur?

Janë raportuar shkelje të supozuara të të drejtave të PI-së në trajnimin e modeleve themelore, megjithëse asnjë prej tyre nuk u është drejtuar parlamenteve. Në veçanti, në vitin 2023, OpenAI u përball me një padi kolektive për të drejtën e autorit në një gjykatë federale të San Franciskos ku pretendohej se chatbot-i i saj i IA-së, ChatGPT, ishte trajnuar për libra pa marrë leje nga autorët.[38] Në të njëjtin vit, "New York Times" ngriti një padi kundër OpenAI dhe Microsoft, duke pretenduar përdorimin e materialeve të saj pronësore për të trajnuar chatbot-e, të cilët tani konkurrojnë drejtpërdrejt me gazetën.[39]

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet mund të shmangin shkeljen e të drejtave të PI-së në të dhënat e trajnimit duke marrë lejet e duhura, duke përdorur të dhëna me burim të hapur ose të licensuar, dhe duke ushtruar kujdesin e duhur për të siguruar që burimet e të dhënave të jenë në përputhje me të drejtat e autorit dhe marrëveshjet e licensimit. Për sistemet e IA-së parlamentare kombëtare ose ndërkombëtare, kjo mund të jetë ende e realizueshme nëpërmjet marrëveshjeve të gjera me agjencitë qeveritare, botuesit, mediat ose pronarët e të dhënave të mëdha.

Megjithatë, për sistemet e trajnuara me të dhëna globale, një qasje e tillë është sfiduese dhe ndoshta jopraktike. Ky eksperiment i mendimit çon në vënien në dyshim të modeleve me objekt të përgjithshëm për përdorimet parlamentare.

Dokumentet parlamentare duhet të përdoren edhe për trajnime, pasi, në parim, ato nuk përfshihen në mbrojtjen e PI-së.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

Rëndësia e respektimit të të drejtave të PI-së duhet të jetë thellësisht e rrënjosur në kulturën institucionale. Megjithatë, përveç aspekteve etike, ka edhe ato ligjore. Prandaj, duhet të ketë bashkëpunim me ekspertë ligjorë të specializuar në të drejtën e PI-së dhe teknologjisë për të siguruar përputhshmëri të plotë me rregulloret e PI-së. Këta ekspertë të brendshëm ose të jashtëm duhet të qëndrojnë të informuar rreth evoluimit të ligjeve të PI-së dhe praktikave më të mira në IA dhe veçanërisht në zhvillimin e LLM-së për t'i përshtatur politikat dhe praktikat sipas rastit.

1.6. Ruani vlerat njerëzore dhe diversitetin kulturor

> Pse ka rëndësi?

Ruajtja e vlerave njerëzore dhe diversitetit kulturor në hartimin dhe zbatimin e IA-së parlamentare është thelbësore për të siguruar që teknologjitë e IA-së të përputhen me normat etike dhe kulturore të shoqërisë së cilës i shërbejnë. Kjo ndihmon në nxitjen e një mjedisi parlamentar më gjithëpërfshirës dhe më të ndjeshëm ndaj kulturës.

> A ka shembuj të njohur?

Rezolutat dhe rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) 2020 trajtuan në mënyrë specifike mundësitë dhe rreziqet e IA-së për të drejtat e njeriut.[40] Të drejtat dhe vlerat e njeriut janë koncepte të ndërlidhura, megjithatë, ndryshe nga të drejtat e njeriut, vlerat nuk janë domosdoshmërisht universale ose ligjërisht detyruese dhe mund të ndryshojnë ndjeshëm në kultura dhe shoqëri të ndryshme.

> Si mund të zbatohet?

Ruajtja e vlerave njerëzore dhe diversitetit kulturor në projektimin e IA-së parlamentare përfshin angazhimin e ekipeve gjithëpërfshirëse të zhvillimit, duke siguruar perspektiva të ndryshme dhe ndjeshmëri kulturore. Ekipet mund t'i nënshtrohen trajnimit të ndjeshmërisë kulturore për të kuptuar nuancat dhe kuadrin përkatës etik.

Megjithatë, shoqëritë mund të jenë gjithashtu thellësisht të ndara mbi vlerat. Vlerat nuk janë të kodifikuara në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe rrjedhimisht janë të vështira për t'u identifikuar ose përshkruar. Prandaj, kur shqyrtohet zbatimi i udhëzimeve në parlamente të caktuara, normat kushtetuese duhet të qëndrojnë në krye të të drejtave të njeriut të kodifikuara universalisht, në vend të termit të paqartë "vlera".

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Bashkëpunoni me organizata kulturore, ekspertë dhe institucione akademike për të fituar njohuri mbi dimensionet kulturore të projektimit dhe zbatimit të IA-së.
- Nxitni kërkime dhe studime akademike mbi pasojat kulturore të përdorimit të IA-së në proceset parlamentare.
- Mbani kanale të hapura komunikimi me komunitete të ndryshme kulturore për të siguruar reagime të vazhdueshme dhe përgjegjshmëri ndaj shqetësimeve të tyre.

1.7. Vlerësoni dhe zbutni pasojat e padëshiruara ose dëmin kolateral

> Pse ka rëndësi?

Institucionet parlamentare mund të jenë proaktive kur vlerësojnë dhe zbutin çdo pasojë të padëshiruar ose dëm kolateral që rezulton nga përdorimi i sistemeve të IA-së, duke siguruar kështu zbatimin e përgjegjshëm dhe llogaridhënës të IA-së në proceset parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Trajtimi i pasojave të padëshiruara të IA-së parlamentare mund të përfshijë disa hapa kompleksë. Së pari, krijimi i një kuadri vlerësimi gjithëpërfshirës është thelbësor. Ky kuadër duhet të përfshijë vlerësime të rregullta të ndikimit, të plotësuara nga auditime të palëve të treta për të dhëna të paanshme. Monitorimi i vazhdueshëm i sistemeve të IA-së do të sigurojë ndërhyrje në kohë. Për më tepër, inkorporimi i mekanizmave të reagimit të përdoruesit do të lejojë të dhëna të drejtpërdrejta, duke mundësuar rregullime për të zbutur çdo efekt negativ dhe për të përmirësuar llogaridhënien dhe performancën e përgjithshme.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Merrni parasysh vlerësimet dhe rekomandimet nga vlerësimi i sistemeve ekzistuese.
- Qëndroni të informuar rreth kërkimeve në zhvillim për IA-në, praktikave më të mira dhe udhëzimeve etike për t'u përshtatur me sfidat në zhvillim dhe për të zbutur pasojat e mundshme.
- Inkurajoni stafin dhe parlamentarët që t'u nënshtrohen trajnimeve mbi sistemet e IA-së dhe pasojat e tyre të mundshme.
- Promovoni kulturën e përdorimit të përgjegjshëm të IA-së brenda mjedisit parlamentar, ku individët inkurajohen të raportojnë shqetësime dhe të propozojnë përmirësime.

1.8. Inkurajoni pjesëmarrjen dhe angazhimin e publikut në zhvillimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të IA-së parlamentare

> Pse ka rëndësi?

Inkurajimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit të publikut në zhvillimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të IA-së mund të merre parasysh gjatë fazës fillestare për të siguruar gjithëpërfshirje, transparencë dhe përfaqësim. Këtu duhet të pasqyrohen vlerat, nevojat dhe perspektivat e publikut të cilit i shërbejnë parlamentet, duke promovuar një proces demokratik më gjithëpërfshirës dhe përfaqësues.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet mund të krijojnë platforma të dedikuara për kontributin e publikut, të organizojnë konsultime publike ose seanca dëgjimore mbi politikat e IA-së, dhe madje të krijojnë borde këshillimore me pjesëmarrjen e qytetarëve. Ekspertët dhe qytetarët duhet të kenë akses në informacion në lidhje me grupet e të dhënave, modelet dhe proceset, duke u mundësuar atyre të ndërveprojnë në mënyrë pjesëmarrëse dhe proaktive. Gjithashtu, parlamentet mund të nxjerrin dokumente të lidhura me IA-në për shqyrtim publik dhe reagime, duke siguruar procese më gjithëpërfshirëse në zhvillimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të IA-së parlamentare.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Promovoni një kulturë të qytetarisë aktive dhe pjesëmarrjes demokratike, ku individët inkurajohen të marrin përsipër një rol aktiv në formësimin e politikave dhe praktikave të IA-së parlamentare.
- Përdorni teknologjinë për të lehtësuar pjesëmarrjen virtuale, duke lejuar qytetarët nga vende të ndryshme të përfshihen në diskutime dhe konsultime.
- Njihni dhe festoni kontributet e qytetarëve dhe organizatave që angazhohen në mënyrë aktive në formësimin e përdorimit të përgjegjshëm të IA-së në parlament.
- Investimi në edukimin për IA-në mund të jetë një tjetër qasje ku qytetarët mund të jenë pjesë e këtyre proceseve të bashkëkrijimit.

1.9. Respektoni shtetin e së drejtës dhe vlerat demokratike

> Pse ka rëndësi?

Respektimi i shtetit të së drejtës dhe vlerave demokratike në zhvillimin dhe përdorimin e IA-së parlamentare është thelbësor për të ruajtur integritetin e proceseve demokratike dhe për të mbështetur parimet ligjore ekzistuese në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar. Kjo ndihmon në promovimin e një mjedisi demokratik dhe ligjor në përputhje me kontekstin parlamentar.

> A ka shembuj të njohur?

Në vitin 2020, PACE miratoi një koleksion rezolutash dhe rekomandimesh, duke analizuar përfitimet dhe rreziqet e mundshme të IA-së kryesisht në lidhje me demokracinë dhe shtetin e së drejtës.[41]

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet duhet të sigurojnë që sistemet e IA-së të përputhen me kornizat ekzistuese ligjore dhe kushtetuese dhe udhëzimet përkatëse të IA-së, duke përfshirë edhe ato etike. Gjithashtu, institucionet përfaqësuese mund të krijojnë mekanizma transparentë të llogaridhënies, të auditojnë rregullisht proceset e IA-së dhe të përfshijnë mbikëqyrjen legjislative për të garantuar përputhshmërinë e IA-së me vlerat demokratike, standardet ligjore dhe kushtetuese dhe të drejtat e qytetarëve.

Rrugët e mundshme për të siguruar garantimin e të drejtave të qytetarëve kur parlamentet përdorin sistemet e IA-së përfshijnë përshtatjen e instrumenteve ekzistuese, siç është Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike,[42] ose miratimin e instrumenteve ligjore specifike që janë aktualisht në zhvillim për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë specifike.[43]

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Nxitni kulturën e ndërgjegjësimit ligjor dhe etik brenda hapësirës së punës parlamentare, duke theksuar rëndësinë e ruajtjes së vlerave demokratike dhe shtetit të së drejtës.
- Bashkëpunoni me ekspertë ligjorë, institucione akademike dhe organizata të shoqërisë civile të specializuara në qeverisjen e IA-së dhe vlerat demokratike.
- Përditësohuni për zhvillimet ligjore në zhvillim dhe praktikat më të mira globale në qeverisjen e IA-së për t'i përshtatur politikat dhe praktikat sipas rastit.



1.10. Përdorni IA-në për të promovuar dhe monitoruar qëllimet kryesore globale, kombëtare ose rajonale të politikave

> Pse ka rëndësi?

Promovimi dhe monitorimi i qëllimeve kombëtare, rajonale ose globale, të tilla si Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), nëpërmjet përdorimit të IA-së parlamentare mund të luajë rol të rëndësishëm në trajtimin e sfidave përkatëse. Monitorimi i këtyre qëllimeve është një nga kompetencat thelbësore të parlamentit përmes funksioneve të tij mbikëqyrëse dhe kontrolluese. Në thelb, kjo qasje është e lidhur me parimet etike, pasi kontribuon në përparimin e përpjekjeve drejt ardhmes më të qëndrueshme dhe të barabartë.

> A ka shembuj të njohur?

Në kuadër të politikëbërjes me gatishmëri digjitale, Shërbimi Shkencor i Parlamentit Helen po koordinon një grup pune për përdorimin e mjeteve të IA-së për monitorimin e OZHQ-ve në nivel kombëtar.[44]

> Si mund të zbatohet?

Zbatimi i një game të gjerë marrëveshjesh ndërkombëtare, si Protokolli i Kiotos dhe Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike, mund të përfitojë nga përdorimi i IA-së parlamentare. IA-ja mund të ofrojë njohuri të bazuara në të dhëna për të mbledhur prova dhe për të informuar parlamentarët dhe politikëbërësit për aspekte të ndryshme të marrëveshjeve të tilla. Prandaj, parlamenti mund të promovojë zbatimin e tyre duke përdorur sistemet e IA-së për të analizuar dhe përmirësuar politikëbërjen, për të monitoruar progresin dhe për të trajtuar çështjet përkatëse të politikave publike.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Inkurajoni dhe bashkëpunoni me zhvilluesit dhe studiuesit e IA-së për t'u përqendruar në krijimin e zgjidhjeve të IA-së që trajtojnë drejtpërdrejt sfidat që lidhen me zbatimin e marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare.
- Promovoni edukimin për IA-në dhe ngritjen e kapaciteteve midis stafit dhe anëtarëve të parlamentit për të lehtësuar iniciativat efektive të drejtuara nga IA-ja për trajtimin e çështjeve që lidhen me qëllimet e përmendura. Për këtë, mund të kërkohen mundësi financimi dhe partneritete për të mbështetur projektet e lidhura me IA-në.

Etika e IA-së në parlamente

Ndërkohë që udhëzimet e IA-së në parlament po zhvillohen më tej, është e domosdoshme të integrohen konsiderata të forta etike. Për ta nxitur këtë, është thelbësore të identifikohen mbështetësit e etikës së IA-së brenda organeve parlamentare, së bashku me advokimin për grante kërkimore etike të IA-së për të nxitur iniciativa vepruese. Për më tepër, duhet të hulumtohet përshtatshmëria e kuadrit etik ekzistues të pranuar, si ata të UNESCO-s,[45] me kontekstet parlamentare. Përqafimi i këtyre hapave do të forcojë angazhimin për zbatimin etik të IA-së dhe do të mbështesë parimet demokratike në epokën digjitale.

2.

Inteligjenca e përgjithshme artificiale dhe autonomia njerëzore
(agjencia dhe autenticiteti)

Identifikuar si teknologji që është "përgjithësisht më e zgjuar se njerëzit",[46] nëse zhvillohet, AGI-ja ka potencialin të ndihmojë dhe madje të zëvendësojë njohjen njerëzore në mënyra që nuk ishin parë më parë. Megjithëse parlamentet janë komplekse, hollësitë e debateve politike dhe çështjeve të politikave po modelohen gjithnjë e më shumë nga IA-ja, dhe AGI-ja mund të ndërmarrë hapin tjetër për të ndihmuar demokracinë.

Është urgjente që parlamentet të marrin në konsideratë marrëdhënien komplekse midis AGI-së dhe autonomisë njerëzore, duke përfshirë si autonominë ashtu edhe autenticitetin.[47] Autonomia e njeriut është e kërcënuar tashmë nga teknologjitë ekzistuese. Përdorimi i sistemeve të AGI-së mund të rrisë ose zvogëlojë autonominë njerëzore, në varësi të mënyrës se si ato janë projektuar dhe cilat fusha janë ndërtuar për të mbuluar.

Përpara se të fillojë ndonjë projekt teknologjik AGI, duhet të bëhet një vlerësim rigoroz i përgjegjësisë etike të projektuesve dhe zhvilluesve. Për të kapërcyer frikën, për të mësuar nga gabimet dhe për të ndërtuar mbi sukseset, duhet të inkurajohet edhe njohja e AGI-së si një perspektivë reale.

2.1. Promovoni autonominë njerëzore, duke përfshirë sigurimin që IA-ja parlamentare të përdoret për të plotësuar aftësitë njerëzore njohëse të nivelit të lartë në vend që t'i zëvendësojë ato

> Pse ka rëndësi?

Promovimi i autonomisë njerëzore duke përdorur IA-në parlamentare si një shtesë dhe jo një zëvendësim mund të jetë thelbësor për ruajtjen e parimeve demokratike dhe ruajtjen e vlerës së gjykimit njerëzor në qeverisje. Institucionet parlamentare mund të udhëheqin përpjekjet për të arritur një ekuilibër midis shfrytëzimit të përfitimeve të IA-së dhe ruajtjes së rolit kryesor të njerëzve në vendimmarrje dhe qeverisje demokratike.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet mund të promovojnë autonominë njerëzore duke përdorur IA-në për të mbështetur dhe rritur vendimmarrjen. Për këtë kërkohet përcaktimi i roleve të qarta të IA-së, trajnime për ligjvënësit dhe përcaktimi i udhëzimeve që i japin përparësi mbikëqyrjes njerëzore dhe përdorimit etik të IA-së. Për më tepër, dhënia e përparësive të projektimit të IA-së me në qendër njeriun, sigurimi i mbikëqyrjes së fuqishme njerëzore dhe nxitja e mekanizmave transparentë të vendimmarrjes përforcojnë më tej angazhimin për të mbështetur parimet demokratike dhe për të ruajtur autonominë individuale.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Në disa sektorë parlamentarë, si në përpunimin e teksteve ligjore ose në fushën e marrjes së informacionit, IA-ja ka të ngjarë të zëvendësojë disa kategori të veprimeve (rutinës) njerëzore. Ky tranzicion nuk duhet të perceptohet si kërcënim për autonominë njerëzore; përkundrazi, mund të kontribuojë në rishpërndarjen e burimeve njerëzore brenda organizatës. Aktualisht, autonomia njerëzore nevojitet për detyrat më të ndërlikuara njohëse, ndërsa ato të përsëritura mund të trajtohen në mënyrë efikase nga mjetet dhe shërbimet e bazuara në IA.
- Në këtë drejtim, parlamentet do të duhet të integrojnë kulturën e përdorimit të përgjegjshëm të IA-së brenda hapësirës së tyre të punës, ku gjykimi njerëzor mbetet qendror për vendimmarrje. Bashkëpunimi me ekspertët e etikës së IA-së, institucionet akademike dhe organizatat e shoqërisë civile është i nevojshëm për të siguruar përafrimin me praktikat më të mira. Gjithashtu, palët parlamentare të interesit do të duhet të qëndrojnë të informuara për përparimet teknologjike në IA, që mund të ndikojnë në autonominë njerëzore dhe vendimmarrjen në proceset parlamentare.

2.2. Zbatoni kërkesa të veçanta për projektuesit dhe zhvilluesit e IA-së parlamentare

> Pse ka rëndësi?

Projektuesit dhe zhvilluesit e sistemeve të IA-së parlamentare kanë përgjegjësi të veçantë etike në lidhje me AGI-në për të parandaluar abuzimet e mundshme dhe për të kufizuar ndikimin e IA-së së fortë ose të singularitetit te institucionet, shoqëria dhe qytetarët. Kjo pasqyron shqyrtimin standard të zbatuar nga çdo organizatë gjatë procesit të punësimit ose gjatë nënkontraktimit të detyrave te shitësit. Është e nevojshme të sigurohet që perspektivat e tyre të gjera dhe vlerat etike të përputhen me ato të institucionit për të ruajtur bashkëpunim harmonik. Prandaj, vlerësimi i projektuesve dhe zhvilluesve të sistemeve parlamentare AGI për përgjegjësinë e tyre etike dhe kryerja e verifikimit të sigurisë janë hapa për të siguruar që sistemet AGI të zhvillohen dhe mirëmbahen me standardet më të larta të integritetit, llogaridhënies dhe sigurisë. Në këtë mënyrë, institucionet parlamentare mund të sigurojnë zhvillimin e teknologjive AGI që përputhen me vlerat dhe parimet etike të institucionit duke ruajtur sigurinë e proceseve parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Aktualisht, nuk ka në fuqi rregullore të qarta specifike për AGI-në. Në mungesë të udhëzimeve të posaçme për AGI-në, legjislaturat mund të zbatojnë në mënyrë analoge praktikat standarde të prokurimit ose të burimeve njerëzore.

> Si mund të zbatohet?

Për të vlerësuar dimensionet etike, në procesin e zhvillimit të sistemit AGI, mund të integrohet shtresë shtesë, duke siguruar përafrimin me praktikat më të mira të industrisë dhe standardet etike institucionale. Parlamenti mund të prezantojë udhëzime etike, verifikim sigurie dhe kërkesa të rrepta kualifikimi. Projektuesit dhe zhvilluesit duhet të demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj përgjegjësisë etike, duke përfshirë vlerësimin e ndikimeve të mundshme shoqërore, sigurimin e transparencës dhe ndjekjen e praktikave më të mira për të mbrojtur institucionet dhe shoqërinë nga rreziqet e lidhura me IA-në.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

Gjatë diskutimeve përfundimtare mes ekspertëve të grupit teknik të punës, përgjegjës për zhvillimin e udhëzimeve, u bë e qartë se ky udhëzim i veçantë jo vetëm që mund të jetë jashtëzakonisht sfidues për t'u zbatuar, por edhe mund të ngrejë polemika të rëndësishme nga këndvështrime të ndryshme etike. Ai është përfshirë këtu në mbështetje të prioritizimit të konsideratave etike në zhvillimin e ardhshëm të AGI-së.

Promovoni të kuptuarit se evoluimi i IA-së është progresiv dhe se AGI-ja duhet të konsiderohet një perspektivë e vërtetë

> Pse ka rëndësi?

Një ditë, AGI-ja mund të jetë perspektivë e vërtetë. Parlamentet, si një vend qendror për vendimmarrje në çdo komb, duhet të jenë të përgatitura. Çdo shtet ka nevojë për vendimmarrje të informuar dhe përgatitje për ndikimet e mundshme shoqërore të IA-së së avancuar. Nga ana tjetër, kjo ndihmon në formimin e qeverisjes së përgjegjshme dhe gatishmërisë për sfidat dhe mundësitë e mundshme që mund të sjellë IA-ja e avancuar.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të promovojë të kuptuarit e IA-së duke lehtësuar edukimin e vazhdueshëm, duke promovuar ndërgjegjësimin e publikut dhe duke angazhuar ekspertë për të diskutuar mbi natyrën progresive të IA-së. Për këtë, mund të merret në konsideratë ngritja e një task force të posaçme. Nxjerrja në pah e potencialit të AGI-së si realiteti i ardhshëm inkurajon planifikimin proaktiv dhe konsideratat etike për zhvillimin e tij përfundimtar.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Qëndroni të informuar për përparimet e IA-së dhe AGI-së, duke përditësuar rregullisht stafin dhe deputetët mbi zhvillimet më të fundit dhe ndikimet e tyre të mundshme.
- Bashkëpunoni me forumet, institucionet kërkimore dhe organizatat ndërkombëtare të përqendruara në AGI për të përdorur ekspertizën kolektive.

Marrja në konsideratë e AGI-së

Duke pasur parasysh debatin e vazhdueshëm rreth fizibilitetit dhe afatit kohor të AGI-së, mund të nevojitet të merren masa proaktive nga parlamenti. Ndërkohë që pasiguria mbulon realizimin e saj, këto udhëzime marrin një qëndrim largpamës, duke njohur nevojën për të vlerësuar dhe trajtuar ndikimet e mundshme në institucionet demokratike, duke siguruar kështu gatishmërinë për përparime të ardhshme teknologjike të tipit të singularitetit.

3.

Privatësia dhe siguria e IA-së

Privatësia dhe siguria e IA-së janë të rëndësishme kur rregullojnë IA-në në mjedisin parlamentar sepse sistemet e IA-së përpunojnë shpesh të dhëna të ndjeshme, si informacione personale ose të dhëna të sigurisë kombëtare. Pa masat e duhura të privatësisë dhe sigurisë, ekziston rreziku i shkeljeve të të dhënave, vjedhjes së identitetit dhe rezultateve të tjera të dëmshme. Kjo mund të cenojë besimin e publikut në procesin parlamentar dhe mund të dëmtojë sistemin demokratik.

Siguria kibernetike dhe privatësia, duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale, përfshihen më së miri në qasjen "sipas projektimit" dhe si të tilla trajnimi, përshtatja dhe zbatimi i modelit të IA-së duhet të ofrojnë garanci për parlamentet përpara miratimit. Përpunimi i sigurt i informacionit personal të identifikueshëm (IPI) është i një rëndësie të madhe. Gjithashtu, duhet të trajtohet edhe marrja në konsideratë e sovranitetit të të dhënave (koncepti që të dhënat i nënshtrohen ligjit të vendit ku mblidhen ose ruhen), duke pasur parasysh natyrën ndërjuridiksionale dhe ndërkombëtare të procedurave parlamentare.

Rreziku i mbështetjes së tepërt në IA është shqetësim, i cili mund të trajtohet vetëm përmes strategjisë të rreptë të IA-së dhe një menaxhimi të kujdesshëm të përdorimeve të saj. Në përgjithësi, mbikëqyrja njerëzore në vendimet e sigurisë duhet të jetë parësore.

3.1. Integroni sigurinë dhe veçoritë e qëndrueshme të sigurisë në sistemet e IA-së parlamentare

> Pse ka rëndësi?

Integrimi i sigurisë dhe veçorive të qëndrueshme të sigurisë në sistemet e IA-së të përdorura në parlament është thelbësore për të mbrojtur individët, intranetin dhe vetë institucionin nga dëmtimet e mundshme dhe kërcënimet e sigurisë kibernetike. Një qasje gjithëpërfshirëse e sigurisë të personalizuar mund të ndihmojë në rritjen e sigurisë dhe sigurimin e sistemeve të IA-së në legjislatura.

A ka shembuj të njohur?

Rezolutat dhe rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) të vitit 2020 për IA-në përfshijnë, ndër të tjera, parimet e sigurisë dhe sigurimit.[48]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të garantojë sigurinë dhe sigurimin e sistemeve të IA-së nëpërmjet testimeve rigoroze, kriptimin dhe pajtueshmëri me standardet e sigurisë kibernetike. Monitorimi i vazhdueshëm, vlerësimi i cenueshmërisë dhe protokollet e reagimit duhet të hartohen për të parandaluar dëmtimin e individëve, për të mbrojtur intranetin dhe për të siguruar mbrojtjen e institucionit nga kërcënimet dhe shkeljet e mundshme.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Nxisni kulturën e ndërgjegjësimit për sigurinë brenda hapësirës së punës parlamentare, ku individët janë vigjilentë dhe paraveprues në identifikimin dhe raportimin e shqetësimeve të sigurisë.
- Krijoni një ekip ose njësi të dedikuar të sigurisë kibernetike përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sigurisë së sistemeve të IA-së.
- Bashkëpunoni me agjencitë qeveritare të sigurisë kibernetike dhe ekspertët për udhëzime për sigurimin efektiv të sistemeve të IA-së parlamentare.
- Mbani parasysh se shumë deputetë duan të punojnë me IA-në që gjeneron tekst. Për një shërbim të tillë duhet të përdoren chatbot-et e brendshme dhe kufizimet e aksesit për të siguruar që të dhënat konfidenciale të mos i zbulohen pa dashje palëve të treta të paautorizuara.

3.2. Përfshini konceptet privatësisë sipas projektimit në zhvillimin e sistemeve të IA-së parlamentare

> Pse ka rëndësi?

Përfshirja e mbrojtjes së privatësisë në projektimin dhe zbatimin e sistemeve të IA-së parlamentare IA mund të jetë e dobishme për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm dhe për të siguruar përdorim të përgjegjshëm të IA-së. Ato duhet të projektohen dhe zbatohen në mënyrë të tillë që të respektojë të drejtat e privatësisë së individëve dhe të jetë në përputhje me ligjet për mbrojtjen e të dhënave, duke promovuar kështu përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të IA-së.

> A ka shembuj të njohur?

Në vitin 2020, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) miratoi një sërë rezolutash dhe rekomandimesh, ndër të tjera, për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave.[49]

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet mund të integrojnë masat e privatësisë duke iu përmbajtur kriptimit të fortë të të dhënave, kontrolleve të aksesit dhe auditimeve të rregullta të sigurisë. Projektimi i IA-së duhet të përfshijë parimet e privatësisë sipas projektimit dhe pajtueshmërinë me rregulloret ekzistuese të mbrojtjes së të dhënave, për të siguruar nivelin më të lartë të mbrojtjes së privatësisë në sistemet e IA-së parlamentare.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Bashkëpunoni me ekspertët e privatësisë, profesionistët ligjorë dhe autoritetet e mbrojtjes së të dhënave për të garantuar përputhjen me rregulloret e privatësisë.
- Angazhohuni në programe të rregullta trajnimi dhe ndërgjegjësimi për stafin dhe anëtarët e parlamentit në lidhje me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave në kontekstin e IA-së.
- Qëndroni të informuar për kërcënimet në zhvillim të privatësisë dhe përshtatja e sistemeve dhe praktikave të IA-së në përputhje me rrethanat.

3.3. Sigurohuni që informacioni personal i identifikueshëm (IPI) i përpunuar nga sistemet e IA-së është i sigurt dhe se ekzistojnë masat e duhura mbrojtëse

> Pse ka rëndësi?

Sigurimi i informacionit personal të identifikueshëm (IPI) në rastet kur përdoren sistemet e IA-së është thelbësor për të mbrojtur privatësinë e individëve dhe për të qenë në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave. Ky udhëzues është një përpunim i udhëzimit të mëparshëm dhe i referohet veçanërisht mbrojtjes së të dhënave personale.

> A ka shembuj të njohur?

Në vitin 2020, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) miratoi një sërë rezolutash dhe rekomandimesh, ndër të tjera, mbi privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave.[50]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti duhet të pranojë se sistemet e IA-së që trajtojnë IPI-të, kërkojnë protokolle strikte të mbrojtjes së të dhënave. Këtu përfshihet zbatimi i kriptimit të fortë, kontrolleve të aksesit dhe auditimeve. Për më tepër, parlamentet duhet të krijojnë mbikëqyrje të brendshme dhe të jashtme për të siguruar përputhjen me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave dhe standardet etike, për shembull nëpërmjet pseudonimizimit automatik të IPI-ve që mund të mbrojë informacionin e ndjeshëm të përpunuar nga sistemet e IA-së.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Pajtohuni me ligjet dhe rregulloret përkatëse për mbrojtjen e të dhënave, të tilla si Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR),[51] Ligji i Transportueshmërisë dhe Përgjegjshmërisë së Sigurimeve Shëndetësore (HIPAA)[52] ose ligje të tjera rajonale të zbatueshme, kur trajtoni IPI-të.
- Përditësimi rregullt i stafit dhe anëtarëve mbi praktikat më të mira të sigurisë së IPI-së dhe politikat e mbrojtjes së të dhënave.
- Bashkëpunoni me ekspertë të privatësisë dhe sigurisë për të siguruar që trajtimi i PII në sistemet e IA-së është në përputhje me standardet e industrisë dhe praktikat më të mira.

Duke ndjekur këto hapa dhe konsiderata, institucionet parlamentare mund të vendosin masa mbrojtëse të forta për të mbrojtur IPI kur përfshihen sistemet e AI, duke garantuar sigurinë dhe privatësinë e të dhënave për individët duke qëndruar në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave.

3.4. Kuptoni se çfarë ruhet, përpunohet dhe mbahet në çdo sistem IA të dhënë nga jashtë

> Pse ka rëndësi?

Kur kontraktoni zgjidhjet e IA-së për përdorim parlamentar, është një parakusht që të keni një kuptim gjithëpërfshirës të të dhënave që ruhen, përpunohen dhe kapen nga sistemi i IA-së, me fokus të veçantë në privatësinë, mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin.

> A ka shembuj të njohur?

Në nivelin e parimeve, shih parimin PACE 2020 IA për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave.[53]Në qershor të vitit 2023, pas dy muajsh eksperimentimi me GPT 4.0, Kryeoficieri Administrativ (CAO) i Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së thirri zyrat e Kongresit për të kufizuar përdorimin e shërbimeve komerciale LLM dhe për të kaluar përsëri në ChatGPT, duke ofruar udhëzime se si të ruheshin të dhënat e ndjeshme.[54]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti duhet të kërkojë praktika transparente të të dhënave, inventar të detajuar të të dhënave dhe vlerësime rigoroze të privatësisë. Kontratat duhet të specifikojnë përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave, ku ofruesit e palëve të treta duhet të respektojnë standardet strikte të privatësisë dhe sigurisë për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm parlamentar dhe për të siguruar përputhjen me rregulloret e privatësisë.

Gjithashtu, ofruesit e shërbimeve duhet të përmbushin standardet strikte që kërkohen në sektorët me nivel të lartë sigurie.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Angazhoni ekspertë ligjorë dhe të privatësisë për të rishikuar kontratat dhe marrëveshjet me shitësin kontraktues në mënyrë që të sigurohet trajtimi i duhur i shqetësimeve mbi privatësinë dhe konfidencialitetin.
- Qëndroni të informuar për rregulloret në zhvillim për mbrojtjen e të dhënave dhe përshtatni marrëveshjet e kontraktimit në përputhje me rrethanat.

3.5. Kuptoni dhe pajtohuni për çdo çështje të sovranitetit të të dhënave dhe infrastrukturës gjatë përpunimit të të dhënave

> Pse ka rëndësi?

Të kuptuarit dhe pajtimi me çështjet e sovranitetit të të dhënave dhe infrastrukturës gjatë përpunimit të të dhënave, veçanërisht në kontekstin e kontraktimit të shërbimeve të IA-së është thelbësor për të siguruar përputhjen me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave dhe për të adresuar shqetësimet e mundshme ligjore dhe gjeopolitike.

> A ka shembuj të njohur?

Përdorimi i sistemeve komerciale të IA-së të zhvilluar dhe me bazë në një shtet mund të jetë një rrezik për çdo parlament në vende të tjera. Shembulli kryesor këtu është ChatGPT[55] nga kompania amerikane OpenAI Inc. Ndonëse përdoret nga Kongresi i SHBA-së, për arsye të sigurisë kombëtare, parlamentet e tjera mund të marrin në konsideratë modele me kod të hapur ose modele specifike të vendit, të ekzekutuara në mjedise infrastrukturore të sigurta dhe të mbrojtura.

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet duhet të identifikojnë shqetësimet e sovranitetit të të dhënave duke kryer vlerësime të ndikimit, duke sqaruar pronësinë e të dhënave, dhe duke vendosur rregulla juridiksionale. Marrëveshjet dhe politikat duhet të përcaktojnë se si përpunohen të dhënat dhe të sigurojnë përputhjen me rregulloret lokale dhe ndërkombëtare, duke nxitur të kuptuarit e përbashkët të sovranitetit të të dhënave brenda kontekstit parlamentar të IA-së. Së fundi, parlamentet kombëtare duhet të eksplorojnë përdorimin e sistemeve të IA-së që përdorin infrastrukturën kombëtare të informatikës me performancë të lartë (HPC).

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Informohuni rreth rregulloreve për zhvillim të sovranitetit të të dhënave dhe zhvillimet gjeopolitike që mund të ndikojnë në marrëveshjet e përpunimit të të dhënave.
- Merrni në konsideratë përdorimin e protokolleve të kriptimit dhe komunikimit të sigurt kur transmetoni të dhëna përtej kufijve për të zbutur rrezikun e përgjimit të të dhënave ose aksesit të paautorizuar.

Duke ndjekur këto hapa dhe konsiderata, institucionet parlamentare mund të navigojnë në mënyrë efektive çështjet e sovranitetit të të dhënave, duke siguruar që të dhënat të përpunohen në përputhje me kërkesat ligjore dhe duke adresuar sfidat e mundshme që lidhen me transferimin ndërkufitar të të dhënave gjatë kontraktimit të sistemeve të IA-së. Në këtë kontekst, sovraniteti i të dhënave të trajnimit dhe testimit mund të hetohet edhe si koncept i veçantë.

3.6. Sigurohuni që IA-ja nuk mund të zëvendësojë materialin burimor origjinal me të dhëna sintetike

> Pse ka rëndësi?

Pranimi i faktit që IA-ja parlamentare nuk duhet të zëvendësojë burimet origjinale me përmbajtje të gjeneruar dhe për rrjedhojë sintetike, por duhet të plotësojë hapësirën dokumentare parlamentare në mënyrë kuptimplote është një udhëzues bazë për përdorimin e përgjegjshëm dhe efektiv të IA-së. Në këtë mënyrë, dokumentet legjislative, procedurale dhe administrative nuk ndryshohen me kalimin e kohës, në mënyrë që të ruhet saktësia dhe integriteti i të dhënave historike dhe bashkëkohore. Sulmet nga softuerë malinj të bazuara në IA që kodojnë dhe mbishkruajnë të dhënat parlamentare janë skenari kritik tipik që duhet shmangur.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti duhet të pranojë se IA duhet të plotësojë, jo të zëvendësojë, materialin burimor origjinal. Ai duhet të vendosë udhëzime strikte dhe rrjedhë pune që i japin përparësi mbikëqyrjes njerëzore dhe vendimmarrjes, ndërsa IA-ja shërben si instrument i vlefshëm për analizën dhe shtimin e të dhënave, duke u siguruar që ajo të plotësojë, në vend që të zëvendësojë, produktet e punës parlamentare.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Krijoni një kulturë të përdorimit të përgjegjshëm të IA-së brenda hapësirës së punës parlamentare, ku theksohet gjykimi njerëzor dhe rëndësia e materialit burimor origjinal.
- Bashkëpunoni me ekspertë dhe organizata të etikës së IA-së për të zhvilluar udhëzime dhe praktika që përforcojnë rolin e IA-së si një mjet plotësues.

Duke ndjekur këto hapa dhe konsiderata, institucionet parlamentare mund të sigurojnë që IA-ja të përdoret në një mënyrë që respekton përparësinë e materialit burimor origjinal dhe gjykimin njerëzor, duke shfrytëzuar përfitimet e IA si një instrument plotësues i vlefshëm.

3.7. Pranoni se mbështetja e tepërt e IA-së mund të jetë e rrezikshme

> Pse ka rëndësi?

Pranimi i rrezikut që vjen si rrjedhojë e mbështetjes së tepërt në sistemet e IA-së në kontekstin parlamentar është thelbësor për të parandaluar krijimin e një ndjenje të rreme sigurie dhe për të ruajtur rolin mbizotërues të gjykimit njerëzor. Institucionet parlamentare mund të vendosin një ekuilibër midis përdorimit të përfitimeve të IA-së dhe ruajtjes së skepticizmit të shëndetshëm për të parandaluar mbështetjen e tepërt dhe ndjenjën e rreme të sigurisë që mund të sjellë.

> A ka shembuj të njohur?

Aktualisht, disa aktorë parlamentarë në mbarë botën që përdorin LLM në punën e tyre. Hulumtimet kanë vënë në dukje rreziqet e mundshme të varësisë së tepruar nga IA-së, e cila mund të krijojë një ndjenjë të rreme sigurie gjatë operacioneve parlamentare. Prandaj, këshillohet të jeni të kujdesshëm dhe të mos keni besim të pakushtëzuar te LLM-të dhe rezultatet e tyre, duke pranuar në të njëjtën kohë edhe probabilitetin e gjenerimit të halucinacioneve dhe gabimeve.[56]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti duhet të jetë vigjilent në lidhje me mbështetjen e tepërt te IA-ja, duke njohur potencialin për vetëkënaqësi dhe ndjenjën e rreme të sigurisë. Prandaj, duhet të ketë përparësi përfshirja dhe vendimmarrja njerëzore dhe të ndiqet një qasje proaktive për menaxhimin e sistemit të IA-së për të parandaluar krijimin e një varësie të panevojshme që mund të rrezikojë integritetin dhe efektivitetin parlamentar.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Nxitni një kulturë brenda hapësirës së punës parlamentare që inkurajon të menduarit kritik dhe angazhimin aktiv të intelektit njerëzor krahas përdorimit të sistemeve të IA-së.
- Kryeni sondazhe të rregullta dhe seanca reagimesh me stafin dhe anëtarët për të vlerësuar perceptimin e tyre për IA-në dhe rolin e saj në proceset parlamentare.

3.8. Siguroni të dhënat e trajnimit dhe testimit të çdo sistemi parlamentar të IA-së për ta mbrojtur atë nga sulmet e sigurisë kibernetike që synojnë ritrajnimin e një sistemi për të bashkëvepruar në një mënyrë specifike

> Pse ka rëndësi?

Sigurimi i të dhënave të trajnimit të sistemeve të IA-së parlamentare është thelbësor për të parandaluar kundërshtarët që të tentojnë të manipulojnë ose ritrajnojnë këto sisteme për qëllime keqdashëse. Kjo mbron integritetin dhe besueshmërinë e njohurive dhe rekomandimeve të gjeneruara nga IA-ja në hapësirën parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Raporte të shumta detajojnë sulmet ndaj sistemeve parlamentare, por deri më tani, nuk ekziston asnjë sulm i regjistruar ose i dokumentuar publikisht ndaj sistemeve të IA-së parlamentare. Qasja e duhur për menaxhimin e të dhënave për IA-në parlamentare mbetet e pakonsoliduar.

> Si mund të zbatohet?

Parlamentet duhet të përdorin masa të forta të sigurisë kibernetike, duke përfshirë kriptimin dhe kontrollet e aksesit, për të mbrojtur të dhënat e trajnimit nga kundërshtarët. Auditimet e rregullta të sigurisë, sistemet e zbulimit të ndërhyrjeve dhe protokollet e rrepta të aksesit të të dhënave mund të parandalojnë përpjekjet e paautorizuara për të ritrajnuar sistemet e IA-së, duke siguruar integritetin e ndërveprimeve parlamentare të IA-së dhe duke mbrojtur kundër ndërhyrjeve me qëllim të keq.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Bashkëpunoni me ekspertë të sigurisë kibernetike për të vlerësuar dhe përmirësuar vazhdimisht sigurinë e të dhënave të trajnimit dhe sistemeve të IA-së.
- Zhvilloni një plan reagimi ndaj incidentit specifik për shkeljet e të dhënave ose incidentet e sigurisë që lidhen me të dhënat e trajnimit.

3.9. Sigurohuni që vendimet e sigurisë të merren nga njerëzit

> Pse ka rëndësi?

Rëndësia e mbikëqyrjes njerëzore dhe sigurimi që vendimet e sigurisë të përshkallëzohen tek operatorët njerëzorë është një aspekt thelbësor i përdorimit të përgjegjshëm të IA-së, veçanërisht në kontekstin parlamentar.

> A ka shembuj të njohur?

Rezolutat dhe rekomandimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) 2020 i referohen në mënyrë specifike parimit të IA-së mbi përgjegjësinë njerëzore për vendimet.[57]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti duhet të zbatojë rregullat e procedurës dhe protokollet që mandatojnë përshkallëzimin e vendimeve të sigurisë për operatorët njerëzorë. Sistemet e IA-së mund të ndihmojnë në zbulimin e kërcënimeve, por vendimet kritike të sigurisë duhet të merren nga njerëzit, të cilët do të marrin në konsideratë llogaridhënien, konsideratat etike dhe kanë aftësinë për t'iu përgjigjur kërcënimeve komplekse në zhvillim në mënyrë efektive.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Përpiquni të krijoni një kulturë vigjilence dhe përgjegjësie brenda hapësirës së punë parlamentare, ku operatorët njerëzorë inkurajohen të angazhohen në mënyrë aktive me sistemet e IA-së dhe të vënë në dyshim rezultatet e tyre kur është e nevojshme.
- Bashkëpunoni me ekspertë dhe profesionistë të sigurisë kibernetike për të përforcuar mbikëqyrjen njerëzore dhe për të përmirësuar masat e sigurisë së IA-së.

Duke ndjekur këto hapa dhe konsiderata, institucionet parlamentare mund të ruajnë rolin parësor të mbikëqyrjes njerëzore në sigurinë e IA-së, duke iu përgjigjur në mënyrë efektive incidenteve të sigurisë dhe duke siguruar përdorim të përgjegjshëm dhe të sigurt të IA-së në kontekstin parlamentar.

4.

Qeverisja dhe mbikëqyrja e IA-së



Sistemet e IA-së duhet të zhvillohen dhe të përdoren në mënyra që janë në përputhje me vlerat dhe proceset demokratike. Mbikëqyrja parlamentare mund të sigurojë legjitimitet për rezultatet e bazuara në IA, ndërsa qeverisja efektive e IA-së mund të promovojë inovacionin dhe të avancojë interesin publik.

Shfaqja e shpejtë e projekteve të IA-së në faza të ndryshme zhvillimi kërkon integrim të kujdesshëm në një strategji parlamentare digjitale më të gjerë. Në vijim të disa sfidave teknologjike, protokollet efikase të qeverisjes dhe menaxhimit të të dhënave duhet të përditësohen për realitetin e ri të përdorimit të gjerë të IA-së. Krijimi i një mbikëqyrjeje etike parlamentare të IA-së do të sigurojë që strategjia dhe praktika të jenë të harmonizuara me kujdes. Ekipet e qeverisjes mund të konsiderohen përgjegjëse për vlerësimin e efekteve të IA-së parlamentare në praktika të ndryshme. Për më tepër, bashkëpunimi me palët e interesuara të IA-së për zhvillimin e politikave do të sigurojë që parlamentet të bëhen agjentë të ndryshimit dhe liderët e miratimit, duke ndihmuar në shfrytëzimin e plotë të potencialit të IA-së në të gjithë shoqërinë.

4.1. Përfshini projektimin dhe zbatimin e sistemeve të IA-së në një strategji më të gjerë parlamentare digjitale

> Pse ka rëndësi?

Përfshirja e projektimit dhe zbatimit të sistemeve të IA-së në një strategji më të gjerë parlamentare digjitale siguron që IA-ja të kontribuojë në mënyrë efektive për qëllimet dhe objektivat parlamentare, ndërkohë që përputhet me përpjekjet e përgjithshme të institucionit për transformimin digjital dhe rrit efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien.

> A ka shembuj të njohur?

Në shkurt të 2024, Komisioni Mbikëqyrës i Aktiviteteve të Dokumentacionit i Dhomës së Deputetëve të Italisë publikoi një sërë parimesh për përdorimin e IA-së për të mbështetur veprimtarinë parlamentare.[58] Sistemet e IA-së parlamentare janë të ngulitura në strategjinë digjitale 2021-2024 të Dhomës së Deputetëve të Brazilit.[59]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të integrojë sistemet e IA-së në një strategji më të gjerë digjitale duke përafruar objektivat e IA-së me qëllimet kryesore parlamentare, duke theksuar bashkëpunimin ndërfunksional, duke siguruar përshkallëzueshmërinë dhe duke përshtatur IA-në për të plotësuar nismat digjitale ekzistuese. Kjo qasje siguron që IA-ja të shërbejë si një komponent integral i ekosistemit digjital parlamentar.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Kërkoni informacion dhe ekspertizë nga specialistët e IA-së, strategët digjitalë dhe drejtuesit e teknologjisë për të informuar procesin e integrimit.
- Rishikoni dhe përditësoni rregullisht strategjinë parlamentare digjitale për t'u siguruar që ajo të mbetet në linjë me peizazhin në zhvillim të IA-së.

4.2. Përdorni protokolle efikase të qeverisjes dhe menaxhimit të të dhënave që garantojnë saktësinë, plotësinë dhe sigurinë e të dhënave të përdorura në sistemet e IA-së

> Pse ka rëndësi?

Për të garantuar saktësinë, plotësinë dhe sigurinë e të dhënave të përdorura në sistemet e IA-së në proceset parlamentare, duke promovuar transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin efektiv të IA-së në proceset parlamentare, duhet të zbatohen protokolle efikase të qeverisjes dhe menaxhimit të të dhënave

> A ka shembuj të njohur?

Ndonëse qeverisja e të dhënave është një koncept i mirëpërcaktuar,[60]skemat specifike të qeverisjes së të dhënave për parlamentet nuk janë përcaktuar. Për më tepër, nuk mund të identifikohej asnjë protokoll gjithëpërfshirës për menaxhimin e të dhënave të përdorura në sistemet e IA-së parlamentar.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të hartojë protokolle rigoroze të qeverisjes dhe menaxhimit të të dhënave për të ruajtur të dhëna të sakta, të plota dhe të sigurta për sistemet e IA-së. Këtu përfshihen kontrollet e cilësisë së të dhënave, kriptimi, kontrollet e aksesit, auditimet e rregullta dhe pajtueshmëri me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave, duke siguruar besueshmërinë dhe integritetin e të dhënave të përdorura në aplikacionet e IA-së.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Bashkëpunoni me ekspertë dhe profesionistë të qeverisjes së të dhënave për të hartuar dhe zbatuar protokolle efektive të qeverisjes së të dhënave.
- Bashkëpunoni me anëtarët dhe stafin e parlamentit për të marrë kontributin dhe komentet e tyre në lidhje me qeverisjen e të dhënave dhe praktikat e menaxhimit të të dhënave. Në këtë kontekst, mund të merren parasysh parimet dhe qasja e të dhënave (menaxhimit) të gjetshme, të aksesueshme, të ndërveprueshme dhe të ripërdorshme (FAIR).[61]

4.3. Krijoni dhe fuqizoni një organ mbikëqyrës etik parlamentar ose delegojani detyrën një komisioni mbikëqyrës ekzistues që shqyrton sistemet dhe aplikacionet parlamentare të IA-së

> Pse ka rëndësi?

Krijimi dhe fuqizimi i një organi parlamentar të mbikëqyrjes etike të IA-së ose delegimi i detyrës një komisioni mbikëqyrës ekzistues është një qasje proaktive për të siguruar përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të sistemeve të IA-së në proceset parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Informacioni aktual mbi organet e mbikëqyrjes etike parlamentare në lidhje me mbikëqyrjen e IA-së mbetet i pakët, pasi parlamentet janë të kujdesshëm me këtë çështje, ndoshta për shkak të ekspertizës së kufizuar në këtë sektor.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të krijojë një organ të dedikuar mbikëqyrës etik ose të fuqizojë një komitet ekzistues për të rishikuar sistemet e IA-së. Ky organ duhet të përbëhet nga ekspertë, ligjvënës dhe palë të interesuara, duke siguruar vlerësime transparente të aplikacioneve të IA-së. Vlerësimet e rregullta, respektimi i udhëzimeve etike dhe llogaridhënia publike mund të kontribuojnë në përdorimin e përgjegjshëm dhe të paanshëm të IA-së në mjediset parlamentare.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Inkurajoni organin mbikëqyrës që të bashkëpunojë me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare që fokusohen në etikën e IA-së, në mënyrë që të qëndrojë i informuar për praktikat më të mira globale.
- Publikimi i punës dhe ndikimit të organit mbikëqyrës është thelbësor për ndërtimin e transparencës dhe besueshmërisë tek aktorët parlamentarë dhe publiku i gjerë.

4.4. Monitoroni efektet e IA-së në një gamë të gjerë çështjesh kritike

> Pse ka rëndësi?

Monitorimi i vazhdueshëm i efekteve të IA-së në një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë pronësinë intelektuale, përgjegjësinë dhe llogaridhënien, punësimin dhe punën, çështjet socio-ekonomike, privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave, paragjykimin dhe diskriminimin, sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, qeverisjen dhe mbikëqyrjen etike, dhe çështjet mjedisore, mund të përdoret për të kuptuar implikimet në lidhje me zbatimin e saj dhe për të marrë vendime të informuara.

> A ka shembuj të njohur?

Vlerësimet e ndikimit përdoren zakonisht në ligjvënie brenda disa sistemeve parlamentare. Megjithatë, vlerësimi i efekteve të IA-së nuk është trajtuar ende praktikisht.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të vlerësojë efektet e IA-së në këto çështje përmes kërkimeve të vazhdueshme, konsultimeve dhe vlerësimeve të ndikimit. Bashkëpunimi me ekspertë, angazhimi i palëve të interesuara dhe rishikimi i rregullt i aplikacioneve të IA-së siguron një vlerësim gjithëpërfshirës, duke i lejuar ligjvënësit të përshtatin politikat dhe rregulloret për të adresuar sfidat në zhvillim në fusha të ndryshme.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Merrni parasysh krijimin e një komisioni parlamentar të dedikuar ose një grupi pune për të mbikëqyrur dhe koordinuar vlerësimin e efekteve të IA-së për çështje të ndryshme.
- Zhvilloni një kornizë gjithëpërfshirëse për kryerjen e vlerësimeve të ndikimit, duke përfshirë metodologjitë e standardizuara dhe mekanizmat e raportimit. Duke kryer vlerësime të plota për këto çështje kyçe, institucionet parlamentare mund të krijojnë të kuptuarit gjithëpërfshirës të efekteve të IA-së dhe të marrin vendime të informuara për të shfrytëzuar përfitimet e saj duke zbutur rreziqet dhe sfidat e mundshme.

4.5. Siguroni akses të sigurt dhe kontroll mbi të dhënat e përdorura në sistemet e IA-së parlamentare

> Pse ka rëndësi?

Sigurimi i aksesit të sigurt dhe kontrollit mbi të dhënat e përdorura në sistemet e IA-së parlamentare është thelbësor për të siguruar llogaridhënien, mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e të dhënave. Kjo nga ana tjetër, kjo i mundëson parlamenteve të monitorojnë proceset e vendimmarrjes nga sistemet e IA-së.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të sigurojë akses të sigurt të të dhënave duke zbatuar protokolle të fuqishme të menaxhimit të të dhënave, kontrollet e aksesit dhe kriptimin. Për të njëjtin qëllim, parlamentet mund të krijojnë politika të qarta për ndarjen e të dhënave, të japin akses vetëm për personat që duhet të kenë akses dhe të auditojnë rregullisht përdorimin e të dhënave për të vendosur një ekuilibër midis sigurisë së aksesit dhe kontrollit në sistemet e IA-së parlamentare.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

Institucionet mund të punësojnë ose të bashkëpunojnë me ekspertë të privatësisë së të dhënave dhe specialistë të sigurisë kibernetike për të hartuar dhe zbatuar masa të fuqishme të aksesit dhe kontrollit të të dhënave. Në të njëjtën kohë, ata mund të qëndrojnë të informuar gjatë gjithë kohës rreth rregulloreve në zhvillim të mbrojtjes së të dhënave për të siguruar përputhjen me kërkesat ligjore në ndryshim.

4.6. Bashkëpunoni me palët e interesuara nga sektorë të ndryshëm për të zhvilluar politika dhe rregullore elastike që nxisin inovacionin duke mbrojtur të drejtat e njeriut

> Pse ka rëndësi?

Bashkëpunimi me palët e interesit nga sektorë të ndryshëm, duke përfshirë parlamentet e tjera, akademinë, shoqërinë civile dhe industrinë, është jetik për zhvillimin e politikave dhe rregulloreve rezistente që do të ruajnë ekuilibrin midis nxitjes së inovacionit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemet e IA-së parlamentare.

>A ka shembuj të njohur?

Në vitin 2017 është formuar "Ekipi Hellenic Optical Character Recognition (OCR)"[62], që është një nismë shkencore për burime të shumta që lehtëson bashkëpunimin midis institucioneve përfaqësuese, studiuesve parlamentarë dhe profesionistëve në mbarë botën.[63] [64]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të nxisë bashkëpunimin me aktorë të ndryshëm përmes dialogut të hapur, grupeve të punës bashkëpunuese dhe shkëmbimit të njohurive. Bashkëpunimi mund të përfshijë të dhëna nga akademia, shoqëria civile, industria dhe rrjetet ndërparlamentare dhe mund të ndihmojë në hartimin e politikave të mirëinformuara që inkurajojnë inovacionin duke respektuar të drejtat e njeriut dhe parimet etike në zhvillimin dhe rregullimin e IA-së.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Rishikoni dhe përditësoni rregullisht politikat dhe rregulloret e IA-së për t'iu përshtatur teknologjisë në zhvillim dhe nevojave të shoqërisë.
- Promovoni transparencën në hartimin e politikave duke i bërë draftet, propozimet dhe vlerësimet e ndikimit të aksesueshëm për shqyrtim dhe reagim nga publiku.

Propozimet kryesore për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e IA-së

Propozimet kryesore për qeverisjen dhe mbikëqyrjen e IA-së mund të përfshijnë emërimin e një zyrtari parlamentar për të mbikëqyrur qeverisjen dhe pajtueshmërinë e IA-së. Për më tepër, krijimi i një portali transparence të IA-së mund të përmirësojë përgjegjshmërinë dhe besimin e publikut. Për më tepër, ofrimi i trajnimeve të IA-së për parlamentarët mund të sigurojë vendimmarrje të informuar dhe përdorim efektiv të teknologjive të IA-së në proceset legjislative.

5.

Projektimi dhe funksionimi i sistemit të IA-së

Projektimi dhe udhëzimet e veprimit ofrojnë një kornizë për prezantimin e IA-së në hapësirën e punës parlamentare. Ata theksojnë rëndësinë e rregullimit të përdorimit të sistemeve të IA-së, vlerësimin e rreziqeve dhe monitorimin e ndikimit të tyre. Përveç kësaj, ata theksojnë nevojën për të siguruar saktësi dhe konsiderata etike, dhe për të përfshirë të gjithë aktorët përkatës në procesin e vendimmarrjes.

Probleme të shumta teknologjike ngrihen nga projektet e IA-së, duke paraqitur si mundësi inovacioni ashtu edhe rreziqe për institucionet parlamentare. Zbatimi i skemave dhe proceseve të standardizuara të të dhënave është thelbësor që IA të përshtatet me natyrën e politizuar të informacionit parlamentar. Theksi mbi shpjegueshmërinë e algoritmeve të IA-së është i rëndësishëm për të siguruar që vendimet e zyrtarëve të zgjedhur mund të lidhen në mënyrë transparente me kriteret dhe provat mbështetëse. Ndërtimi i sistemeve të fuqishme dhe të besueshme të IA-së do të krijojë një shqetësim edhe më të madh për riprodhueshmërinë e vendimeve dhe mësimin nga rastet më të mira. Parlamentet mund të ndihmojnë edhe në rregullimin e përdorimit dhe zbatimit të IA-së, si në institucionet e tyre ashtu edhe për shoqërinë, duke vepruar si përdorues kryesorë. Monitorimi dhe vlerësimi i sistemeve të IA-së do të kërkojë një arkitekturë të hapur që mundëson akses më të gjerë të ekipeve të mbikëqyrjes tek përdoruesit fundorë me miratimin e tyre. Në fund të fundit, palët e interesuara parlamentare duhet të arrijnë një marrëveshje për nivelet minimale të saktësisë, cilësinë e vendimmarrjes dhe performancën institucionale.

5.1. Zbatoni skema dhe procese të standardizuara të të dhënave për të siguruar ndërveprim dhe përputhshmëri në platforma dhe aplikacione të ndryshme të IA-së

> Pse ka rëndësi?

Zbatimi i skemave dhe proceseve të standardizuara të të dhënave, mundësisht duke përdorur standardet e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO), është i nevojshëm për të siguruar ndërveprim dhe përputhshmëri në platforma dhe aplikacione të ndryshme brenda sistemeve të IA-së parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Është e domosdoshme të zhvillohen baza të dhënash të strukturuara, të vërtetuara dhe të hapura, mundësisht në një format të standardizuar. Standardet ligjore si Akoma Ntoso (AKN) mund të ofrojnë përfitime afatgjata duke lehtësuar harmonizimin e burimeve ligjore dhe ndërveprimin sistematik.[65] AKN përdoret rregullisht nga Parlamenti Evropian, Senati i Italisë, Senati i Brazilit, Parlamenti i Uruguait, Dhoma e Deputetëve të Argjentinës, Dhoma e Deputetëve të Kilit, institucionet e Mbretërisë së Bashkuar dhe Dhoma e Përfaqësuesve të SHBA.[66]

> Si mund të zbatohet?

Një parlament mund të krijojë një organ rregullator të centralizuar për të përcaktuar dhe zbatuar skemat dhe proceset e standardizuara të të dhënave. Ky organ duhet të bashkëpunojë me ekspertë të teknologjisë, të përcaktojë udhëzime të qarta dhe të mandatojë respektimin e të gjitha platformave dhe aplikacioneve, duke nxitur ndërveprueshmërinë dhe përputhshmërinë, si dhe duke garantuar respektimin e standardeve të sigurisë dhe privatësisë së të dhënave.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Kryeni rishikime dhe përditësime periodike të skemave dhe proceseve të standardizuara të të dhënave për të përshtatur nevojat në zhvillim të të dhënave dhe përparimet teknologjike.
- Kërkoni informacion dhe komente nga ekspertët dhe palët e interesuara në menaxhimin e të dhënave dhe ndërveprueshmërinë për të përmirësuar vazhdimisht përpjekjet e standardizimit.

5.2. Theksoni shpjegueshmërinë e algoritmeve të IA-së

> Pse ka rëndësi?

Theksimi i shpjegueshmërisë së algoritmeve të IA-së në lidhje me rastet e përdorimit parlamentar bën që arsyetimi pas vendimeve dhe rekomandimeve të bazuara në IA të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i arritshëm për palët përkatëse të interesuara. Kjo është thelbësore për nxitjen e besimit, të kuptuarit dhe transparencës dhe për të mundësuar vendimmarrje të informuar brenda sistemeve të IA-së parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të mandatojë sisteme transparente të IA-së duke u kërkuar zhvilluesve të përdorin algoritme të shpjegueshme. Kjo përfshin përdorimin e modeleve të interpretueshme, sigurimin e dokumentacionit të kuptueshëm dhe krijimin e mekanizmave mbikëqyrës për të siguruar llogaridhënie.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Komunikoni qartë kufizimet e shpjegimeve të algoritmeve të IA-së për të menaxhuar pritshmëritë dhe për të shmangur keqkuptimet.
- Zhvilloni modele ose udhëzime të standardizuara për shpjegimet e algoritmit të IA-së për të mundësuar qëndrueshmëri dhe qartësi.

5.3. Ndërtoni sisteme të IA-së parlamentare të fuqishme dhe të besueshme që përfshijnë aftësinë për të zbuluar dhe korrigjuar gabimet dhe dështimet

> Pse ka rëndësi?

Ndërtimi i sistemeve të IA-së parlamentare të fuqishme dhe të besueshme me aftësinë për të zbuluar dhe korrigjuar gabimet është thelbësore për ruajtjen e integritetit dhe efektivitetit të këtyre sistemeve.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të sigurojë sisteme të forta të IA-së duke mandatuar testime rigoroze, monitorim të vazhdueshëm dhe zbatimin e mekanizmave të provuar që nuk do të dështojnë. Auditimet e rregullta, qarqet e reagimeve dhe një organ i përkushtuar mbikëqyrës mund të zbulojnë dhe korrigjojnë gabimet menjëherë, duke rritur besueshmërinë dhe duke ruajtur integritetin e sistemeve të IA-së parlamentare.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Kryeni auditime të rregullta të sistemit dhe rishikime pas zbatimit për të identifikuar fushat për përmirësim në besueshmërinë e sistemit dhe trajtimin e gabimeve.
- Bashkëpunoni me ekspertë në inxhinierinë e softuerit dhe inxhinierinë e besueshmërisë për të siguruar që do të ndiqen praktikat më të mira.

5.4. Rregulloni përdorimin dhe vendosjen e sistemeve të IA-së parlamentare, duke përfshirë vlerësimet e rrezikut, kërkesat për licencimin dhe standardet e sigurisë

> Pse ka rëndësi?

Rregullimi i përdorimit dhe vendosjes së sistemeve të IA-së parlamentare, si nëpërmjet instrumenteve ligjërisht të detyrueshme dhe jo të detyrueshme, është jetik për të siguruar miratimin e përgjegjshëm dhe etik të teknologjive të IA-së në proceset parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Nga mesi i vitit 2024, nuk janë identifikuar masa specifike rregullatore. Këto udhëzime mund të shërbejnë si frymëzim ose bazë për përcaktimin e masave të tilla në parlamente.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të rregullojë sistemet e IA-së duke përdorur korniza gjithëpërfshirëse, duke kryer vlerësime të rrezikut dhe duke përcaktuar kërkesat e licencimit. Zbatimi i standardeve të sigurisë, auditimet periodike dhe bashkëpunimi me ekspertët siguron vendosje të përgjegjshme, duke nxitur një mjedis të sigurt dhe të përgjegjshëm për sistemet e IA-së parlamentare.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Bashkëpunoni me ekspertë në rregullimin e etikës, ligjit dhe teknologjisë së IA-së për të siguruar që kuadri rregullator të jetë gjithëpërfshirës dhe i përditësuar.
- Kërkoni informacion dhe komente nga palët përkatëse të interesit, duke përfshirë shoqërinë civile, akademinë dhe industrinë gjatë zhvillimit dhe rishikimit të rregulloreve të sistemeve të IA-së.

5.5. Vlerësoni rrezikun e përdorimit të produkteve të softuerëve si shërbim (SaaS) ose zbatimit të bazuar në renë kompjuterike që përmban veçori të IA-së

> Pse ka rëndësi?

Kryerja e vlerësimit të rrezikut gjatë përdorimit të një produkti SaaS ose zbatimi i bazuar në renë kompjuterike me veçori të IA-së siguron respektimin e analizave etike dhe masave të tjera mbrojtëse.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur të kuadrit rregullator ku është i nevojshëm vlerësimi i rrezikut posaçërisht për sistemet e IA-së parlamentare. Në kuptimin më të gjerë, Ligji i BE-së për IA-në përfshin dispozita të krahasueshme në lidhje me sistemet me aftësi dhe ndikimi të veçantë.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të kryejë një vlerësim të plotë të rrezikut të SaaS ose shërbimeve të IA-së të bazuara në renë kompjuterike duke vlerësuar privatësinë e të dhënave, masat e sigurisë, analizat etike dhe transparencën e shitësit. Vendosja e udhëzimeve rregullatore, kërkesat e certifikimit dhe monitorimi i vazhdueshëm siguron mbrojtje etike dhe gjithëpërfshirëse në vendosjen e teknologjive të tilla.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Bashkëpunoni me ekspertë në etikë e IA-së dhe IA-në përgjegjëse për të kryer vlerësime të plota të rrezikut dhe për të siguruar që masat mbrojtëse etike janë në vend.
- Inkurajoni dialogun e hapur me ofruesin për të adresuar çdo rrezik ose shqetësim të identifikuar dhe kërkoni angazhimin e tyre për përdorimin etik të IA-së.

5.6. Monitoroni dhe vlerësoni funksionimin dhe rezultatin e sistemeve të IA-së parlamentare

> Pse ka rëndësi?

Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt dhe sistematik i sistemeve të IA-së parlamentare është i nevojshëm për të vlerësuar me saktësi ndikimin e tyre në proceset dhe rezultatet parlamentare. Monitorimi i vazhdueshëm i rezultateve të sistemit të brendshëm të IA-së mundëson vendimmarrje të informuar dhe aftësinë për të përshtatur rregulloret për zbatimin e përgjegjshëm parlamentar të IA-së. Kjo rrit besimin te instrumentet dhe inkurajon përdorimin e tyre të mëtejshëm nga deputetët dhe administratorët.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të prezantojë vlerësime të rregullta duke krijuar komisione mbikëqyrëse ose duke bashkëpunuar me ekspertë të jashtëm për të ofruar vlerësime të paanshme. Për më tepër, burimet dhe personeli mund të ndahen për të kryer vlerësime të tilla.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

Institucionet parlamentare duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë vazhdimisht funksionimin dhe rezultatin e sistemeve të tyre të IA-së. Kjo qasje aktive mundëson përmirësimin e vazhdueshëm, përdorim të përgjegjshëm të IA-së dhe përafrim me qëllime më të mëdha shoqërore.

5.7. Bini dakord për një nivel minimal saktësie me të gjithë aktorët përkatës përpara se të pranoni një zbatim të IA-së

> Pse ka rëndësi?

Niveli i dëshiruar i saktësisë për çdo sistem të caktuar parlamentar të IA-së varet nga zbatimi specifik dhe përdorimi i synuar. Marrëveshja për një nivel minimal saktësie për zbatimin e IA-së me palët përkatëse të interesit është një hap vendimtar për të siguruar që sistemet e IA-së të përmbushin objektivat e tyre të synuara dhe përdoren në mënyrë efektive.

> A ka shembuj të njohur?

Nuk ka shembuj të njohur.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të sigurojë saktësinë minimale duke vendosur standarde të performancës, kryer vlerësime të pavarura dhe duke kërkuar të dhëna nga aktorë të ndryshëm. Testimi rigoroz, transparenca në proceset e vlefshmërisë dhe kërkimi i reagimeve lehtësojnë vendimet e informuara për zbatimin e IA-së, duke nxitur besimin dhe besueshmërinë midis të gjithë aktorëve përkatës.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Kur përcaktohen objektivat e saktësisë, duhet të merren parasysh pasojat e mundshme si të alarmeve të rreme pozitive (false positives), ashtu edhe të atyre negative (false negatives), pasi ato mund të kenë ndikime të ndryshme në varësi të kontekstit të përdorimit.
- Inkurajoni komunikimin e hapur dhe transparent me palët e interesit gjatë gjithë procesit për të ndërtuar besim dhe për të siguruar përafrimin me qëllimet e saktësisë.

Mjediset e testimet sandbox dhe laboratorët e inovacionit

Kur zhvillohet teknologjia parlamentare, puna brenda mjediseve të testimit sandbox për IA-të nxit eksperimentimin në një mjedis të kontrolluar, duke lejuar eksplorimin e zbatimit të IA-së pa rrezikuar ndërprerje operacionale. Për më tepër, krijimi i laboratorëve të inovacionit ofron hapësira të dedikuara për zgjidhjen e problemeve bashkëpunuese dhe zhvillimin e përsëritur të zgjidhjeve të IA-së të përshtatura për nevojat parlamentare. Këto nisma kanë potencialin për të promovuar shkathtësinë dhe inovacionin, ndërkohë që sigurojnë integrimin e pandërprerë të teknologjive të IA-së në hartimin dhe funksionimin e sistemeve parlamentare.

6.

Ngritja e kapaciteteve të IA-së dhe edukimi

Ngritja e kapaciteteve dhe edukimi janë elementë të rëndësishëm të prezantimit të IA-së në hapësirën e punës parlamentare, sepse ato mund të ndihmojnë në ndërtimin e njohurive dhe aftësive mes parlamentarëve dhe stafit, gjë që nga ana tjetër është thelbësore për përdorimin efektiv dhe të përgjegjshëm të IA-së. Kjo përfshin të kuptuarit e teknologjive të IA-së, zbatimet e tyre të mundshme dhe ndikimin e tyre në shoqëri, si dhe konsideratat etike dhe ligjore që duhet të merren parasysh. Duke investuar në ngritjen e kapaciteteve dhe arsimin, parlamentet mund të sigurojnë se janë të pajisur për të naviguar mundësitë dhe sfidat e IA-së. Ndërtimi i kapaciteteve dhe edukimi përfshin sigurimin e burimeve të nevojshme të deputetëve dhe stafit parlamentar për të angazhuar dhe informuar publikun mbi IA-në, dhe përdorimin e saj në hapësirën e punës parlamentare.

Krijimi i ekipeve të ekspertëve që përfshijnë një sërë palësh të interesuara në një mjedis të hapur mund të ndihmojë në mësimin dhe përhapjen e praktikave më të mira. Organizimi i programeve të trajnimit të IA-ve do të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për ngritjen e kapaciteteve dhe edukimin, brenda dhe jashtë parlamentit.

IA ka marrë hov të madh në mbarë botën, duke i mundësuar parlamentet të përfitojnë nga shkëmbimi i njohurive dhe bashkëpunimi në të gjitha segmentet e shoqërisë. Edukimi i publikut për përdorimin dhe kufijtë e IA-së në parlament do të sigurojë që perceptimet dhe pritshmëritë të mbeten brenda realitetit, burimeve dhe aftësive të çdo juridiksioni.

6.1. Ndërtoni një ekip ekspertësh të përkushtuar për të vazhduar me risitë teknologjike në fushën e IA-së dhe më gjerë

> Pse ka rëndësi?

Ndërtimi dhe zgjerimi i ekipit të ekspertëve për të vazhduar me risitë e teknologjisë në fushën e IA-së dhe më gjerë do të thotë që institucionet parlamentare mund të qëndrojnë të informuar, të marrin vendime të informuara dhe të shfrytëzojnë në mënyrë efektive përfitimet e IA-së.

> A ka shembuj të njohur?

Detyra të tilla mund të merren përsipër nga organet e parashikimit. Parlamenti finlandez operon me Komisionin për të Ardhmen, i cili në praktikë funksionon si një qendër e brendshme mendimi.[67] Në vitin 2021, ky organ organizoi një seancë parlamentare inovative të një sistemi AI.[68]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të ndërtojë një ekip ekspertësh duke investuar në trajnime të vazhdueshme, duke bashkëpunuar me specialistë të jashtëm dhe duke krijuar partneritete me institucionet arsimore dhe industrinë e IA-së. Përditësimet e rregullta të njohurive, punësimi ndërdisiplinor dhe nxitja e një kulture inovacioni u mundësojnë ekipeve parlamentare të qëndrojnë krah për krah me teknologjitë në zhvillim të IA-së.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Inkurajoni anëtarët e ekipit të publikojnë punime kërkimore, raporte dhe artikuj për të kontribuar në bazën më të gjerë të njohurive në fushën e IA-së.
- Nxitni një kulturë inovacioni brenda ekipit, duke lejuar eksperimentimin dhe kreativitetin në eksplorimin e aplikacioneve të IA-së për proceset parlamentare.
- Përcaktoni se si do të ndërtoni lidhje institucionale me burimet e ekspertizës, për shembull, përmes stafit të specializuar në departamentet e kërkimit dhe lidhjeve me komitetet që adresojnë IA-të.

6.2. Organizimi i shpeshtë i programeve të trajnimit për IA-në për zyrtarët dhe administratorët parlamentarë

> Pse ka rëndësi?

Organizimi i programeve të shpeshta të trajnimit rreth IA-së për zyrtarët dhe administratorët parlamentarë do të ndihmojë në zhvillimin e aftësive kritike të njohurive për IA-në dhe promovimin e përdorimit të përgjegjshëm dhe etik të tij brenda institucioneve parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Shembuj për programet e trajnimit për IA-të për zyrtarët dhe administratorët parlamentar përfshijnë "AI Insight Forum" për Senatorët e SHBA[69] dhe uebinarët nga Qendra e Inovacionit në Parlament (CIP) e Unionit Ndërparlamentar (IPU).[70]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të organizojë programe trajnimi për IA-në në partneritet me institucionet arsimore dhe industrinë, duke organizuar seminare dhe duke krijuar module të aksesueshme në internet. Theksimi i konsideratave etike, privatësisë së të dhënave dhe nxitja e të menduarit kritik siguron që zyrtarët dhe administratorët parlamentarë të zhvillojnë aftësi thelbësore të njohurive për IA-të, duke promovuar përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të IA-së.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Përdorni platforma dhe burime digjitale të të mësuarit për të lehtësuar të nxënit në distancë ose me ritëm të pavarur dhe për të inkurajuar komunikimin dhe shkëmbimin e përvojave në parlamente.
- Krijoni akademi dhe qendra të ekselencës së IA-së në parlamente, duke kultivuar ekspertizën teknike dhe duke mundësuar bashkëpunimin.
- Merrni parasysh platformat e mësimit në internet[71] dhe kurset masive të hapura në internet (MOOCs) që ofrojnë burime të aksesueshme për zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive, duke siguruar që deputetët dhe stafi të qëndrojnë të përditësuar për aftësitë, rreziqet dhe dëmet në zhvillim - duke përdorur një qasje 'vëzhguese'.
- Inkurajoni pjesëmarrësit të ndajnë njohuritë dhe përvojat e IA-së në ekipet dhe departamentet e tyre për të promovuar kulturën e ndarjes së njohurive.
- Merrni në konsideratë se si pajisja e deputetëve me mjete dhe burime mund t'u mundësojë atyre të edukojnë publikun, duke nxitur transparencën dhe kuptimin e publikut të implikimeve të IA-së në proceset parlamentare.

6.3. Mbështetni shkëmbimin e njohurive me aktorë të jashtëm dhe pjesëmarrjen në skemat e bashkëpunimit dy dhe shumëpalësh

> Pse ka rëndësi?

Mbështetja e shkëmbimit të njohurive me aktorë të jashtëm dhe pjesëmarrja në skemat e bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh janë strategji jetike për institucionet parlamentare për të qëndruar të informuar, për të bashkëpunuar dhe për të shfrytëzuar ekspertizën në fushën e teknologjive në zhvillim, duke pasuruar kuptimin e tyre për IA-në dhe teknologjitë në zhvillim dhe duke kontribuar në qeverisjen e përgjegjshme dhe etike të IA-së në proceset parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Shkëmbimi i njohurive për çështjet e IA-së lehtësohet për shembull nëpërmjet Partneritetit Global për IA-së (GPAI),[72] nismës së Kombeve të Bashkuara "AI for Good"[73] dhe – në kontekstin më të ngushtë ndërparlamentar – Qendrës së IPU-së për Inovacionin në Parlament (CIP).

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të mbështesë shkëmbimin e njohurive duke krijuar forume, partneritete dhe projekte bashkëpunuese me aktorë të jashtëm. Pritet që aktorët parlamentarë të shkëmbejnë informacione me njëri-tjetrin ose të konsultohen me ekspertë për udhëzimet dhe qasjet e përshtatshme.

Pjesëmarrja aktive në skemat e bashkëpunimit dy dhe shumëpalësh nxit shkëmbimin e informacionit, përparimet teknologjike dhe përafrimin e politikave, duke promovuar një qasje të informuar globalisht dhe të ndërlidhur ndaj sfidave parlamentare, duke përfshirë ato që lidhen me IA-në.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

Promovoni gjithëpërfshirjen duke përfshirë aktorë nga prejardhje dhe rajone të ndryshme për të siguruar një perspektivë të gjerë mbi qeverisjen dhe etikën e IA-së dhe inkurajoni pjesëmarrjen aktive në nismat ndërkombëtare të qeverisjes së IA-së.

6.4. Dokumentoni hapat drejt dhe rezultatet e aktiviteteve të lidhura me IA-në

> Pse ka rëndësi?

Dokumentimi i drejtë i hapave dhe rezultateve të aktiviteteve të lidhura me IA-në ndërton kujtesën institucionale dhe lejon shpërndarjen e njohurive brenda institucioneve parlamentare.

> A ka shembuj të njohur?

Kur bëhet fjalë për aktivitetet e lidhura me IA-në, Departamenti i Dokumentacionit Shkencor dhe Mbikëqyrjes së Shërbimit Shkencor në kuadër të Kuvendit të Greqisë ka shprehur publikisht dhe institucionalisht përkushtimin e tij për shtimin e kujtesës institucionale dhe ndarjen e njohurive me aktorët e brendshëm.

Dhoma e Deputetëve të Brazilit ka zhvilluar Caggle, një platformë digjitale bashkëpunuese,[74] për të lehtësuar regjistrimin, analizën dhe ndarjen e projekteve dhe eksperimenteve të drejtuara nga të dhënat. Kjo platformë i mundëson anëtarëve të punojnë së bashku në mënyrë efektive, duke siguruar që njohuritë dhe rezultatet nga aktivitetet e lidhura me IA-në janë të mirë-dokumentuara dhe të disponueshme për të mësuarit dhe zhvillimin e vazhdueshëm organizativ.

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të dokumentojë aktivitetet e IA-së duke mbajtur shënime të detajuara, duke krijuar korniza të standardizuara të raportimit dhe duke përdorur sisteme të menaxhimit të njohurive. Shpërndarja e rregullt e përditësimeve tek aktorët e brendshëm siguron akumulimin e kujtesës institucionale, duke nxitur transparencën dhe vendimmarrjen e informuar në përpjekjet parlamentare të IA-së.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

- Merrni në konsideratë përdorimin e softuerit të menaxhimit të dokumenteve ose platformave të menaxhimit të njohurive për të lehtësuar ruajtjen, rikthimin dhe ndarjen efikase të dokumentacionit të lidhur me IA-në.
- Inkurajoni stafin që të kontribuojë në dokumentacion në mënyrë aktive dhe të njohë kontributin e tyre në kujtesën institucionale.

6.5. Informoni publikun për përdorimin dhe kufijtë e sistemeve të IA-së në parlament në mënyrë të arritshme

> Pse ka rëndësi?

Informimi i publikut për përdorimin dhe kufijtë e IA-së në parlament në mënyrë lehtësisht të kuptueshme është thelbësore për transparencën institucionale dhe besimin e publikut. Qytetarët fitojnë njohuri mbi proceset e ligjbërjes dhe mbikëqyrjes, duke ndërtuar kështu besimin në përkushtimin e institucionit për zbatimin e përgjegjshëm dhe llogaridhënien për IA-në. Informimi i publikut për përdorimin dhe kufijtë e IA-së në parlament, promovon transparencën, llogaridhënien dhe angazhimin publik në çështjet që lidhen me IA-në.

> A ka shembuj të njohur?

Nënkomiteti i Modernizimit të Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA-së ka filluar të publikojë "raporte flash" të rregullta që identifikojnë përdorimin e planifikuar të sistemeve të IA-së në agjencitë mbështetëse legjislative.[75]

> Si mund të zbatohet?

Parlamenti mund të informojë publikun duke lançuar fushata ndërgjegjësimi, organizuar forume publike dhe duke krijuar burime të përshtatshme për përdoruesit. Komunikimi transparent, shpjegimet në gjuhë të thjeshtë dhe angazhimi përmes kanaleve të ndryshme mediatike ndihmojnë në përcjelljen e përdorimit dhe kufijve të sistemeve të IA-së në parlament në një mënyrë të arritshme dhe të kuptueshme.

> Rekomandime dhe konsiderata të mëtejshme

